

PLANI I VEPRIMIT

PËR ZBATIMIN E DEKLARATËS SË SOFJES PËR
AGJENDËN E GJELBËR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR
2021-2030



PËRMBAJTJA

HYRJE	3	PLANI I VEPRIMTARIVE PËR BUJQËSI TË QËNDRUESHME	25
ORGANIZIMI/STRUKTURA E PLANIT TË VEPRIMIT	4	Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	25
PJESA 1 – PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E DEKLARATËS SË SOFJES	5	Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	25
DEKARBONIZIMI	5	PLANI I VEPRIMTARIVE PËR MBROJTJEN E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT	28
EKONOMIA QARKULLUESE	8	Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	28
ELIMINIMI I NDOTJES	9	Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	29
BUJQËSIA E QËNDRUESHME	10	PJESA 3 – QEVERISJA, MONITORIMI, RAPORTIMI DHE MEKANIZMAT E TJERË PËR TË MBËSHËTETUR ZBATIMIN E DEKLARATËS SË SOFJES	31
MBROJTJA E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT	11	QEVERISJA	31
PJESA 2 – PLANI I VEPRIMTARIVE PËR ZBATIM	12	PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE	34
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR KLIMËN	12	PJESËMARRJA NË QEVERISJEN VENDORE	35
Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	12	PLATFORMA E BASHKËRENDIMIT TË DONATORËVE DHE FINANCIMI I AGJBP-SË	36
Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	13	PJESËMARRJA E KOMUNITETIT TË BIZNESIT, RINISË DHE GRUPEVE VULNERABËL, PËRFSHIRË KOMUNITETIN ROM	37
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR ENERGIJË	14	SISTEMI I MONITORIMIT	38
Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	14	INDIKATORËT	39
Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	15	RAPORTIMI	42
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR TRANSPORTIN E QËNDRUESHËM	16	KOMUNIKIMI, RRIJTJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE PJESËMARRJA E QYTETARËVE	42
Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	16	SHKURTIME	44
Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	16		
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR EKONOMINË QARKULLUESE	18		
Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	18		
Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	19		
PLANI I VEPRIMTARIVE PËR ELIMINIMIN E NDOTJES	21		
Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor	21		
Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme	22		

HYRJE

Ky Plan Veprimi përfaqëson një prej rezultateve të Deklaratës së Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor (AGjBP) dhe përdoret si mjet për të orientuar zbatimin e saj. Aty gjen shprehje paradigma e “kthimit të fjalëve në vepra” përmes identifikimit të afateve konkretë dhe organizatave mbështetëse si dhe përmes përcaktimit të afateve kohore indikative për secilën masë të zbatueshme. Plani i Veprimit parashtron kuadrin për të bashkërenduar dhe mbështetur zbatimin e duhur të tij dhe për të mbikëqyrur ecurinë e zbatimit. Për rajonin e Ballkanit Perëndimor, Samiti i Sofjes përfaqëson një gur kilometrik i cili duhet të nxisë kalimin drejt paradigmës së zhvillimit dhe ta përkrahë rajonin për të ndërmarrë transformime madhore dhe për të gjetur në kohë zgjidhjet e duhura ndaj sfidave në rritje mjedisore dhe klimatike e duke vendosur në qendër të veprimtarive ekonomike zhvillimin e qëndrueshëm, eficientë e burimeve, mbrojtjen e natyrës dhe veprimtaritë në mbrojtje të klimës duke i transformuar këto sfida në mundësi.

Plani i Veprimit (PV) u përgatit pas një procesi të gjerë konsultimesh të koordinuar nga Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (KBR) dhe u hartua në vijim të një qasje nga poshtë-lart me pjesëmarrjen e autoriteteve nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (BP), organizatave më në zë rajonale të cilat janë aktive në fushat e politikave që mbulohen nga AGjBP-ja, institucioneve ndërkombëtare financiare (INF), organizatave të shoqërisë civile (OShC), dhe partnerëve të tjerë. Komisioni Europian (KE), Drejtorja e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat për Zgjerimin (DP FNZ) kanë luajtur gjithashtu një rol kyç në bashkërendimin e veprimtarive dhe duke dhënë ekspertizë në të gjitha fushat përmes konsultimeve me Drejtoritë e Përgjithshme (DP) të linjës. Kjo qasje me pjesëmarrje të gjerë ka mundësuar në këtë mënyrë dhënien e ndihmës konstruktive nga aktorë të ndryshëm, duke iu përmbajtur parimit të autorësisë rajonale gjë që ka

kontribuar në cilësinë e saj përmes shfrytëzimit të këndvështrimeve të ndryshme dhe përmes njohurive dhe përvojave të ndryshme.

Ky dokument përfshin periudhën nga viti 2021 deri në vitin 2030 dhe është hartuar në mënyrë të atillë që të mund të rishikohet sistematikisht sipas nevojave dhe prioriteteve të reja, e pa zbritur nga niveli i ambicieve. Çdo shtyrje e afateve kohore duhet justifikuar. Perspektiva dhjetë-vjeçare e Planit të Veprimit mundëson harmonizimin e tij me objektivat më të rëndësishme ndërkombëtare dhe europiane të politikave si Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ) të Kombeve të Bashkuara (KB), Kuadri Europian 2030 për Klimën dhe Politikat e Energjisë, Strategjia e BE-së për Biodiversitetin 2030, Strategjia “Nga Ferma në Pirun”, Ekonomia Qarkulluese si dhe Planet e Veprimit për Ndotje Zero. Plani i Veprimit do të rishikohet dy herë: në fund të vitit 2024 dhe në fund të vitit 2027, duke përdorur të njëjtin proces konsultues me autoritetet e Ballkanit Perëndimor dhe organizatat rajonale partnere, duke bërë kështu dhe analizën e arritjeve të përmbushura kundrejt objektivave të PV-it.

Ky Plan Veprimi përcakton kuadrin për bashkërendimin dhe monitorimin e tij, ndërsa përgjegjësia kryesore për implementimin e këtij plani u takon autoriteteve të Ballkanit Perëndimor në vijim të bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërinstytucional. Ky Plan Veprimi merr parasysh proceset kryesore politike, kuadret dhe marrëveshjet ndërkombëtare, zhvillimet më të fundit të politikave dhe në veçanti aktet legjislativë dhe jo-legjislativë të miratuara në nivel BE-je. Këtu përmendim Agjendën e Gjellbër Europiane (AGjE), (kuadri i BE-së për klimën, Strategjinë e BE-së “Nga Ferma në Pirun”, Paketën “Fit for 55%”, Plani i Veprimit për Ndotje Zero, etj.) objektivat/ambiciet e Ballkanit Perëndimor për energjinë dhe klimën për vitin 2030 në përputhje me qëllimet e mesme klimatike për uljen e emetimeve të gazrave serrë (GS) me të paktën 55%, si dhe shumë të tjera si këto.

ORGANIZIMI/STRUKTURA E PLANIT TË VEPRIMIT

Plani i Veprimit është i ndërtuar në mënyrë të atillë që të pasqyrojë shtatë komponentët e Deklaratës së Sofjes (Klimën, Energjinë, Transportin, Ekonominë Qarkulluese, Ndotjen, Bujqësinë e Qëndrueshme, Mbrojtjen e Natyrës dhe Biodiversitetin) të grupuar në pesë shtylla. Aty përmbledhen masat për të përmbushur 58 angazhimet (objektivat) që vijnë nga Deklarata e Sofjes si dhe përcaktohen koordinatorët kryesorë rajonalë dhe organizata të tjera të rëndësishme të cilat kontribuojnë në objektiva të veçantë. Në konsultim me koordinatorët rajonalë dhe autoritetet e Ballkanit Perëndimor përcaktohen afatet kohore për zbatimin e secilës masë.

Ndërsa pjesa e parë e PV-së përmban masat dhe afatet e skadimit kur edhe duhet të përfundohet veprimtaria në fjalë, dhe se cili entitet ngarkohet për ta koordinuar dhe mbështetur atë, pjesa e dytë paraqet në mënyrë më të hollësishme rrugën që duhet ndjekur sipas planeve të veprimtarive për të realizuar secilin komponent. Planet e veprimit përshkruajnë veprimet dhe hapat rajonale që duhet të ndërmerren, objektivat e ndërmjetme, rezultatet e nevojshme dhe elementet e tjera që nevojiten për ta orientuar rajonin drejt përmbushjes së angazhimeve që dalin nga Deklarata e Sofjes. Shtatë planet e veprimtarive u hartuan nga KBR-ja dhe koordinatorët rajonalë në komunikim të ngushtë me autoritetet e Ballkanit Perëndimor, Komisionin Europian dhe partnerë të tjerë me rëndësi. Procesi u realizua përmes një sërë konsultimesh dhe takimesh periodike të Grupit Rajonal të Punës për Mjedisin (GRP Mje.) në formatin tij të zgjeruar në mënyrë që të përfshihen edhe ministri të tjera të linjës të cilat janë të rëndësishme për zbatimin e AGJBP-së. Rrugët e përcaktuara në planet rajonale të veprimtarive paraqesin hapat themelore në drejtim të qëndrueshmërisë ekologjike dhe sociale dhe do të kenë rëndësi të madhe në ndihmën që do të japin për të përmbushur Marrëveshjen e Parisit për Klimën përmes kontributit që japin në sektorë të ndryshëm ekonomik. Për të zbatuar këto plane duhet të bëhet prioritetizimi dhe të ndiqet radha e duhur e veprimeve plotësuar kjo me përpjekjet e bashkërenduara të të gjithë aktorëve

me rëndësi si dhe me bashkëpunimin e fortë ndërsektorial si në nivel ekonomie edhe në nivel rajonal.

Për ecurinë e mire të këtij Plani Veprimi nevojitet ekspertiza e duhur në të gjitha fushat e zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes mjedisore dhe ndryshimeve klimatike, mbështetjes teknike, fuqisë vendim-marrëse, strukturës së fuqishme të qeverisjes, përfshirë këtu një mekanizëm gjithpërfshirës dhe të dobishëm monitorimi për të mundësuar shqyrtimin dinamik dhe të kuptueshëm të progresit, për të identifikuar nevojat dhe për të ndërhyrë me masat e duhura korrigjuese apo për të intensifikuar përpjekjet. Për këtë arsye, pjesa e tretë e këtij Plani Veprimi paraqet një përmbledhje të mekanizmave qeverisës, monitorues dhe raportues, si dhe të strukturave të tjera që duhen ngritur dhe mobilizuar për të lehtësuar implementimin, për të garantuar qasjen e shumë aktorëve dhe bashkërendimin vertikal, dhe për të mbështetur shkëmbimin e njohurive të nevojshme dhe veprimtaritë ndërgjegjësuese në nivele të ndryshme përfshirë dhe nivelin e qeverisjes vendore. Implementimi i Deklaratës së Sofjes mbart me vete një përpjekje të madhe financiare, ndërkohë që suksesi i saj do të varet, në shkallë të madhe, nga mbështetja e duhur financiare plotësuar kjo me asistencën teknike dhe shkëmbimin e njohurive. Për këtë arsye, pjesa e tretë përmban gjithashtu informacion që trajton financimin e PV-së dhe veprimtarive që mbështesin bashkërendimin e burimeve të disponueshme financiare.

Ky Plan Veprimi është zhvilluar duke marrë parasysh realitetin e rajonit në fjalë dhe disa vonesa të caktuara në zbatimin e politikave të rëndësishme të BE-së dhe procesit të harmonizimit. Ai synon të ndryshojë praktikat negative të cilat dëmtojnë gjendjen e mjedisit në rajon, si dhe të transformojë të gjithë sektorët ekonomik në përputhje me parimet e tranzicionit të gjelbër. Në këtë mënyrë ky dokument do të lehtësojë zhvillimin rajonal që plotëson nevoja e gjeneratës aktuale dhe asaj të ardhshme e nga ana tjetër do të hapë mundësi të reja ekonomike duke garantuar se rritja e përshpejtuar nuk do të dëmtojë mjedisin.

PJESA 1 – PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E DEKLARATËS SË SOFJES

Kjo pjesë e Planit të Veprimit përcakton një afat kohor indikativ për secilin nga : ndahet në 5 shtylla të cilat pasqyrojnë strukturën e AGjBP-së: 1) Dekarbonizimi, angazhimet e Deklaratës së Sofjes dhe identifikon koordinatorët kryesorë rajonalë, 2) Ekonomia Qarkulluese, 3) Eliminimi i Ndotjes, 4) Bujqësia e Qëndrueshme dhe organizatat mbështetëse (aty ku gjen zbatim), dhe strukturat e rëndësishme. Tabela : 5) Mbrojtja e Natyrës dhe Biodiversitetit.

DEKARBONIZIMI

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Komenti
1. Harmonizimi me Ligjin e BE-së për Klimën me një vizion për arritjen e objektivave të neutralitetit të klimës deri në vitin 2050	KBR, (+ SKEn për t'u konfirmuar)	2025	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
2. Vendosja e qëllimeve të energjisë dhe klimës deri në vitin 2030	SKEn, KE	2022 (në zhvillim e sipër)	Bazuar në studimin e KE-së, KPK, SZHKU dhe PKEK; Bashkëpërfitimet për reduktimin e ndotjes së ajrit
3. Krijimi dhe zbatimi i Planeve të integruara të Energjisë dhe Klimës	SKEn	2022 (në zhvillim e sipër)	Bazuar në studimin e KE-së; Zbatimi deri në vitin 2030
4. Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të adaptimit të ndryshimeve klimatike	KBR	2028 (në zhvillim e sipër)	Bazuar në proceset PKP
5. Harmonizimi me Sistemin e BE-së për Tregtimin dhe/ose futjen e instrumenteve të tjera të çmimit të karbonit	SKEn (për t'u konfirmuar)	2024 (në zhvillim e sipër)	Bazuar në vendimin për futjen e instrumentit të çmimit të karbonit-diskutimet e politikave ende vazhdojnë
6. Rritja e mundësive për krijimin e zgjidhjeve natyrore për zbutjen dhe adaptimin e ndryshimeve klimatike	KBR, UNRN	2025	Përmirësimi i vazhdueshëm deri në vitin 2030; Lidhje me Veprimin 54
7. Garantim i pjesëmarrjes së ekonomive të BP-së në Paktin European të Klimës apo të konsiderohet krijimi i mekanizmave të ngjashëm.	KBR	2022	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
8. Shqyrtim dhe rishikim, kur është e nevojshme, i të gjitha rregulloreve përkatëse për të mbështetur dekarbonizimin gradual të sektorit të energjisë.	SKEn, KBR	2023 (në zhvillim e sipër)	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
9. Përgatitja e vlerësimit të ndikimit socio-ekonomik të dekarbonizimit në nivelin e ekonomive individuale dhe në nivel rajonal	KBR	2022	

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Komenti
10. Prioritizimi i efijencës së energjisë dhe përmirësimit të saj në të gjithë sektorët	SKEn, SPKT, KBR	Në zhvillim e sipër	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
11. Transpozimi dhe zbatimi i plotë i Direktivës për Performancën Energjitime të Ndërtesave	SKEn	2023	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
12. Mbështetja e programeve për rinovimin e ndërtesave private dhe publike dhe sigurimi i fondeve të përshtatshme	SKEn	Në zhvillim e sipër	Zhvillimi i konceptit nga KE-ja ende vazhdon; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
13. Rritja e pjesës së burimeve të rinovueshme të energjisë dhe krijimi i kushteve të nevojshme të investimit	SKEn	Në zhvillim e sipër	Përditësimi i acquis-ve ende vazhdon; Vini re: çdo rritje e djegies së biomasës duhet kryer duke marrë parasysh impaktin në ndotjen e ajrit; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
14. Zvogëlimi dhe eliminimi gradual i subvencioneve të qymyrit, në përputhje të plotë me rregullat e ndihmës shtetërore.	SKEn	Në zhvillim e sipër	Duhet të reflektohet në PKEK-të; Bashkëpërfitime të ajrit të pastër.
15. Garantimi i pjesëmarrjes në Nismën për Mbështetjen e Rajoneve të Qymyrit në Tranzicion në Ballkanin Perëndimor	SKEn	Në zhvillim e sipër	Bashkëpërfitime të ajrit të pastër nga reduktimi i djegies së qymyrit
16. Zhvillimi i programeve për të adresuar problemin e varfërisë energjitime dhe financimin e skemave për rindërtimin e familjeve dhe sigurimin e standardeve themelore të jetesës	SKEn	Në zhvillim e sipër 2024	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
17. Mbështetja e zhvillimit të infrastrukturës inteligjente, promovimi i nxitjes së teknologjive novatore (si transporti pa bileta, inteligjenca artificiale, bileta multimodale e pasagjerit, lëvizshmëria si shërbim, aplikacionet e kalimit kufitar të kufirit, korridoret 5G, etj)	SPKT, SKEn	Në zhvillim e sipër	Të rëndësishme për planifikimin e integruar të infrastrukturës energjitime dhe asaj të transportit/e furnizimit; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
18. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Reformën Hekurudhore	SPKT	2023	Përmirësim i pritshëm i infrastrukturës.
19. Përcaktimi i korridoreve për transportin hekurudhor dhe rrugët ujore të brendshme	SPKT	2027	Rrjeti i korridoreve të transportit hekurudhor po rishikohet nga KE-ja.
20. Përcaktimi i një strategjie të përgjithshme për të zhvendosur trafikun nga rruga në modalitete më miqësore me mjedisin.	SPKT	2021	Strategjia e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe Inteligjente për BP-në është pregatitur nga SPKT dhe i është paraqitur Këshillit Ministerial të TKT-së
21. Identifikimi i standardeve teknike të BE-së dhe sigurimi i zbatimit dhe i digjitalizimit të të gjitha mënyrave të transportit.	SPKT	2030	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
22. Zbatimi i Planit Rajonal të Veprimit për Përmirësimin e Transportit	SPKT	2023	

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Komenti
23. Zbatimi i Planit të Veprimit për Sigurinë Rrugore	SPKT	2022	
24. Zbatimi i Planit të Veprimit për Trafikun Rrugor	SPKT	2024	
25. Zhvillimi dhe zbatimi i planeve të rezistencës ndaj ndryshimeve klimatike për rrjetet e transportit të ekonomive të Ballkanit Perëndimor.	SPKT, KBR	2022	Lidhja me Veprimin e Klimës
26. Promovimi i përgatitjes dhe zbatimit të Planeve të Qëndrueshme të Lëvizjes Urbane për zonat urbane të Ballkanit Perëndimor	SPKT, KBR (përmes Samitit të QV-të)	2025	Përfitimet e ajrit të pastër; Promovim i fuqishëm deri në vitin 2025, Zbatim i mëtejshëm.
27. Përcaktimi i zgjidhjeve për lëvizshmëri të qëndrueshme në nivel rajonal përfshirë planet për zhvillimin e karburanteve alternative.	SPKT (Infrastruktura e karburanteve alt.), SKEn (furnizimi me karburante alt.), KBR	2024	Përfitime të ajrit të pastër
27a. Përcaktimi i një plani për ndërtimin e stacioneve të furnizimit për automjetet elektrike.	SPKT	2022	
28. Forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e zhvillimit të infrastrukturës për alternativat e karburantit.	SPKT, KBR	2023	Përfitime të ajrit të pastër

EKONOMIA QARKULLUESE

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Koment
29. Përmirësimi i qëndrueshmërisë së prodhimit primar të lëndës së parë.	KBR	2030	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
30. Zbatimi i një qasjeje në ekosistemin industrial për të arritur një rikuperim ekonomik të qëndrueshëm e të ekuilibruar në mjedis.	KBR	2025	Përmes integritit të objektivave të Strategjisë së re Industriale për Europën
31. Zhvillimi i strategjive të ekonomisë qarkulluese duke marrë parasysh të gjithë ciklin jetësor të produktit	KBR	2023	Strategji mbarë ekonomike duhen përgatitur brenda fundit të vitit 2023; Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë duke hartuar/kanë hartuar Planin e Veprimtarive të Ekonomisë Qarkulluese
32. Progresi i mëtejshëm në ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve për qytete dhe rajone	KBR	2025	Progresi i bërë duhet raportuar brenda vitit 2025; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
33. Planifikimi dhe zbatimi i iniciativave të orientuara drejt konsumatorit për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për mbetjet, për grumbullimin e diferencuar dhe konsumin e qëndrueshëm	KBR	2022	Një fushatë rajonale për t'u organizuar nga KBR-ja
34. Lidhja dhe zbatimi i një marrëveshjeje rajonale për parandalimin e ndotjes nga mbetjet plastike dhe në veçanti, adresimi i çështjes prioritare të ndotjes detare	PPMA, KBR	2022	PPMA mund të nisë procesin e hartimit të një marrëveshjeje rajonale për ndotjen detare, por për shkak të afatit të kufizuar kohor të projektit (deri në shtator 2022) nuk do arrihet të shihet finalizimi i saj; Lidhja me Veprimet 43 dhe 52
35. Zbatimi i mëtejshëm i Strategjive të Specializimit të Zgjuar të cilat përfaqësojnë plane transformimi të bazuara në vendndodhje për qëndrueshmëri, bazuar në novacion	KBR	2024	Lidhja me nismën e Tregut të Përbashkët Rajonal (TPR)

ELIMINIMI I NDOTJES

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Koment
36. Përfundimi i procesit të ratifikimit të Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me rreze të gjatë dhe protokollet e saj	KBR	2025	Ekonomitë e BP-së kanë miratuar planet e reduktimit të emetimeve brenda SKEn-së; Duhet përcaktuar angazhimet për uljen e emetimeve
36a. Mbështetja e modeleve për të përcaktuar angazhimet për uljen e emetimeve në mbarë ekonominë për pesë ndotësit kryesorë që mbulojnë nga Direktiva e AKE dhe Protokollin i Göteborgut sipas Konventës për Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me rreze të gjatë	KBR	2025	Mundësia e përfshirjes së ekipit të modelimit JRC
37. Vendosja dhe zbatimi i Strategjive të Cilësisë së Ajrit	KBR, SKEn	2030	Disa ekonomi të BP-së kanë zhvilluar strategji brenda strategjive të tyre mjedisore; Zbatimi - përtej vitit 2030
37a. Zbatimi më intensiv i teknikave më të mira në dispozicion në përputhje me Direktivën e Emetimeve Industriale	KBR, SKEn	2030	
38. Vendosja e një sistemi të përshtatshëm të monitorimit të cilësisë së ajrit, përfshirë akreditimin e rrjeteve të monitorimit të cilësisë së ajrit	KBR, SKEn	2025	Zhvillimi i sistemit rajonal për sigurimin e cilësisë
39. Zbatimi i acquis përkatës të BE-së për ujë (Direktiva Kuadër e Ujit e BE-së, Direktiva e Trajtimin të Ujrave të Zeza Urbane dhe Direktiva e Nitrateve)	KBR	2027**	Në përputhje me afatin përfundimtar për DKU
40. Modernizimi i infrastrukturës së monitorimit të ujit dhe përbushja e statusit të mirë për të gjithë trupat ujore	KBR	2030**	Përmirësim i vazhdueshëm deri në fund të vitit 2030
41. Ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për trajtimin e ujërave të ndotura	KBR	2030**	Përmirësim i vazhdueshëm deri në fund të vitit 2030
42. Integrimi i mbrojtjes së tokës në zona të tjera strategjike dhe krijimi i një partneriteti rajonal për mbrojtjen e tokës në mënyrë që të rritet shkëmbimi i njohurive dhe të identifikohen shembuj të praktikës së mirë në mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe degradimi	KBR, GPP ZHRR	2024	Në vijim të afatit të përcaktuar në Planin e Veprimtarive të BE-së Zero Ndotje
43. Përgatitja dhe nënshkrimi i marrëveshjes rajonale për ndotjen ndërkufitare të ajrit dhe të ujit	KBR	2023	Lidhet me Veprimtaritë 34-52

** Afatet kohore për zbatimin e Veprimtarive 39, 40 dhe 41 mund të përcaktohen në një moment të dytë nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor në kuadër të procesit të negociatave dhe zgjerimit.

BUJQËSIA E QËNDRUESHME

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Koment
44. Harmonizimi i sektorit të ushqimit dhe prodhimit primar me standardet e BE-së për sigurinë e ushqimit, shëndetin dhe mirëqenien bimëve dhe kafshëve, dhe mjedisin dhe adresimin e çështjeve të menaxhimit të ujërave të zeza, plehrave dhe mbeturinave	GPP ZHRR	2026	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
45. Forcimi i kontrolleve sanitare përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor dhe përmirësimi i sistemit të përcaktimit të origjinës dhe etiketimit të produkteve ushqimore	GPP ZHRR	2027	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
46. Promovimi i bujqësisë ekologjike dhe organike (me zero ndotje) dhe zvogëlimi i përdorimit të kimikateve sintetike në prodhimin e ushqimit	GPP ZHRR	2026	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
47. Bashkëpunim me institucionet shkencore, arsimore, të biznesit dhe bujqësisë për të lehtësuar transferimin e teknologjive novatore dhe mjedisore dhe metodave bujqësore.	GPP ZHRR	2026	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
48. Hartimi i veprimtarive për të zvogëluar mbeturinat në zonat rurale dhe bregdetare	GPP ZHRR	2030	Menaxhimi i mbetjeve kërkon mjete të mëdha financiare për të ekzekutuar/ zbatuar masat e synuara
49. Rritja e përpjekjeve që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale me zbatimin e programit LEADER	GPP ZHRR	2026	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
50. Mbështetja e investimeve në prodhimin dhe teknologjinë e energjisë së rinovueshme, si dhe në uljen e emetimeve të GS dhe masat për përshtatjen e bujqësisë ndaj ndryshimeve klimatike	GPP ZHRR, SKEn	2027	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030

MBROJTJA E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT

Veprimtaria	Koordinatori (ët) kryesorë rajonal(ë)	Afati kohor indikativ	Koment
51. Zhvillimi dhe zbatimi i Planit Strategjik për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor 2030	UNRN, KBR	2021-2030	Zbatimi deri në vitin 2030
51a. Hartimi i një Raporti për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor	UNRN	2021-2022	Konsultime me autoritetet, OShC-të BP-së dhe organizatat ndëkombëtare
51b. Zhvillimi i një Plani Strategjik për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor	UNRN	2022-2024	Konsultime me autoritetet, OShC-të BP-së dhe organizatat ndëkombëtare
52. Përgatitja e planeve për mbrojtjen dhe rigjallërimin e natyrës përfshirë zonat detare	UNRN, KBR, PPMA	2022-2024	Konsultime gjithëpërfshirëse me organizata të BP-së dhe ato ndëkombëtare; Lidhet me Veprimtaritë 34 dhe 43
53. Zhvillimi dhe zbatimi i Planit për Rinovimin e Peizazheve Pyjore të Ballkanit Perëndimor	UNRN, KBR	2021-2030	Zbatimi deri në vitin 2030
53a. Përgatitja e një Raporti Vlerësimi për Mundësitë e Rinovimit	UNRN	2021-2022	Konsultime me autoritetet, OShC-të BP-së dhe organizatat ndëkombëtare
53b. Përgatitja e një Plani Rinovimi të Peizazheve Pyjore (përfshirë edhe planin financiar)	UNRN	2022-2024	Konsultime me autoritetet, OShC-të BP-së dhe organizatat ndëkombëtare
54. Analizimi i përfitimeve nga zgjidhjet natyrore për biodiversitetin dhe mundësinë e integritit të tyre në klimë dhe plane të tjera	UNRN, KBR	2021-2023	Lidhet me Veprimtarinë 6
54a. Raportim mbi lidhjet e ndryshimeve klimatike me biodiversitetin	UNRN	2021-2022	
55. Forcimi i mekanizmave për bashkëpunimin rajonal dhe planifikimin strategjik për ruajtjen e biodiversitetit dhe zbatimin e detyrimeve sipas Konventës së Biodiversitetit Biologjik	UNRN, KBR	2021-2030	Përfshirë marrëveshje të tjera që lidhen me biodiversitetin; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
56. Forcimi i angazhimit të marrë në kuadër të Konventave të OKB-së Rio (dhe sinergjia mes të trejave) si dhe e përpjekjeve të përbashkëta për të përgatitur një dokument rajonal për një agjendë globale të biodiversitetit pas vitit 2020	UNRN, KBR	2021-2022	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
57. Ngritja e një Qendre të dedikuar Informimi për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor për të përmirësuar shkëmbimin e njohurive dhe disponueshmërinë e informacionit	UNRN, KBR	2021.-2024	Parametrat dhe treguesit duhet të jenë në përputhje me ato të përcaktuara nga BE-ja dhe KDB; Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030
57a. Kuadri i Monitorimit dhe Vlerësimit të Biodiversitetit	UNRN, KBR	2021.-2024	
58. Zhvillimi i ndërlidhjes së Infrastrukturave të Gjelbra me ekosistemin	KBR, PPMA, UNRN	2022-2023	Përmirësim i vazhdueshëm deri në vitin 2030

PJESA 2 – PLANI I VEPRIMTARIVE PËR ZBATIM

Shtatë planet e veprimtarive që paraqiten në këtë kapitull ofrojnë orientim strategjik për Ballkanin Perëndimor dhe udhëzime se si të nisë dhe të zhvillohet procesi i përbushjes së Angazhimeve të Sofjes gjatë dhjetëvjeçarit të parë të zbatimit dhe të hedhë themelet e forta për arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Këto plane veprimtarish janë përgatitur bazuar në zhvillimet më të fundit sipas AGJE-së dhe duke patur parasysh gjendjen aktuale në disa fusha strategjike në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Planet e veprimtarive përfaqësojnë operacionilizimin e masave kyçe të dakordësuara nga Udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor në Sofje dhe ofrojnë udhëzime të hollësishme mbi atë se çfarë duhet bërë në lidhje me ndërmarrjen e masave shtesë, kryerjen e studimeve bazë, mbledhjen e të dhënave, zhvillimin e vizioneve dhe dokumenteve strategjike, ngritjen e strukturave të nevojshme, përcaktimin e objektivave të ndërmjetme, forcimin e bashkëpunimit, etj. Shtatë kapitujt e mëposhtëm identifikojnë prioritetet dhe hapat e nevojshëm për të lehtësuar procesin e integritit të objektivave të AGJE-së në kuadrin politik dhe ligjor të ekonomive në rajon me synim maksimizimin e intensitetit dhe shfrytëzimin e potencialit të plotë të tranzicionit të gjelbër të parashikuar gjatë viteve të para të zbatimit.

Plani i Veprimtarive për Klimën

Pjesa e pare: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Numi i angazhimeve sipas të cilave do të arrihet emetimi zero neto i gazrave serrë po rritet globalisht. Me miratimin e Agjendës të Gjelbër Europiane, BE-ja është e vendur që të ketë rolin e udhëheqësit global dhe të drejtojë tranzicionin drejt emetimeve zero neto, duke ndihmuar dhe frymëzuar të tjerë që ta ndjekin në të njëjtën rrugë. Ballkani

Perëndimor iu bashkua kësaj nisme me nënshkrimin e Deklaratës së Sofjes për AGjBP-në. Ky angazhim thekson nevojën për të përcaktuar qartë rrugën që do të eksplorojë ndryshimet e nevojshme në sektorë të ndryshëm ekonomik për ta përbushur këtë qëllim ambicioz deri në vitin 2050. Prioriteti më i madh për rajonin e Ballkanit Perëndimor është përshtatja me urgjencë ndaj politikave të klimës, përcaktimi i synimeve tranzitore klimatike (energjitike) 2030 të harmonizuara me ambiciet e rritura të BE-së, transpozimi i Paketës “Fit for 55” dhe i Ligjit të BE-së për Klimën, rritja e rezervuarëve për depozitimin e karbonit në mënyrë natyrore dhe artificiale si dhe sigurimi i një transformimi të gjelbër për të gjithë sektorët ekonomik veçanërisht ato mbi baza karboni.

Në aspektin global, qymyri ka qenë boshti i zhvillimit ekonomik të njerëzimit qysh prej fillësive të epokës industriale. Rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk përbën përjashtim kur dhe një pjesë e madhe e energjisë (rreth 70%) prodhohet nga impiante energjitike të cilat punojnë me qymyr. Provat shkencore, ndryshimet klimatike për të cilat jemi të gjithë dëshmitarë, si dhe ndikimi negativ që kanë në shëndet ndotësit e ajrit, si në periudha afat-shkurtra ashtu edhe në ato afat-gjata, e vërtetojnë se ky model ekonomik nuk është i qëndrueshëm në periudha afatgjata dhe kjo praktikë negative duhet të ndalet. Djegia e qymyrit shkakton rreth 4,000 vdekje të parakohshme çdo vit në Ballkanin Perëndimor, gjë që çon drejtpërsëdrejti në kosto shëndetësore dhe në ulje prodhueshmërie të cilat përllogariten të jenë € 11 miliardë çdo vit², përfshirë dëmi që u shkaktohet Vendeve fqinje Anëtare të BE-së (VA). Megjithatë braktisja e teknologjive ku dhe mbështeten më së shumti ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe kalimi nga qymyri tek energjia e rinovueshme do të sjellë me vete sfida të mëdha socio-ekonomike të cilat duhet të kapërcehen nga rajoni i Ballkanit Perëndimor për të zgjidhur pasojat e padëshiruara siç janë papunësia, problemet ekonomike, migrimi i fuqisë punëtore dhe pasoja të tjera

2 Raporti: Veprimtaria e BE-së për ndotjen kronike të Ballkanit Perëndimor nga qymyri është një mundësi unike për të përmirësuar shëndetin dhe prodhueshmërinë, <https://caneurope.org/report-eu-action-on-western-balkans-chronic-coal-pollution-is-a-unique-opportunity-to-improve-health-and-productivity/>

potenciale negative. Megjithatë, ky tranzicion është qartësisht i nevojshëm për hir të shëndetit të njeriut, mjedisit dhe klimës.

Për ta realizuar këtë tranzicion, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të përcaktojnë objektiva të detyrueshme me ligj me afatet dhe mënyrat përkatëse të realizimit, e nga ana tjetër duhet të garantojnë mekanizmat rregullatorë dhe financiarë dhe kapacitetet për zbatimin e tyre. Një nga parakushtet për veprimet efëçente dhe të suksesshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor është dialogu i strukturuar mes partnerëve dhe grupeve të synuara.

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Duke njohur dhe pranuar nevojën për të hartuar një rrugë drejt neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të zhvillojnë dhe miratojnë strategjitë e tyre afatgjata të zhvillimit për emetime në nivele të ulta të gazrave serrë (strategji afatgjata) në përputhje me dispozitat e Ligjit të BE-së për Klimën, Rregulloret e Qeverisjes dhe elementë të tjerë të kuadrit të BE-së për politikën klimatike, dhe t'i miratojë ato pa vonesa të mëtejshme dhe jo më vonë se deri në vitin 2025. Këto strategji afatgjata duhet të përqendrohen në sektorët që punojnë me karbon (energjinë dhe transportin) dhe të përcaktojnë objektiva gjithëpërfshirës ekonomik për reduktimin e emetimeve nga të gjitha modalitetet e transportit, ndërtesat, bujqësia, industria dhe sektori i mbetjeve.

Për të zbuluar mënyrën e duhur për heqjen graduale të qymyrit nga prodhimi i energjisë nga aspekti social dhe i drejtë, autoritetet e Ballkanit Perëndimor duhet të ngrënë Komitetin e Dekarbonizimit (KD) me një mandatin për të zhvilluar, deri në vitin 2024, një Program Veprimi për Eliminimin e Qymyrit (PVEQ). Komiteti duhet të ketë në përbërjen e tij aktorë të ndryshëm nga fusha e politikës, biznesit, mjedisit, përfshirë këtu përfaqësues nga degët dhe kompanitë e prekura, sindikatat dhe aktorë të tjerë të interesuar. Programi i Veprimtarive (i cili duhet të harmonizohet me Planin Kombëtar të Energjitikës dhe Klimës) duhet të përmbajë një grup instrumentesh dhe një vizion

strategjik për eliminimin gradual të prodhimit të energjisë bazuar në qymyr, përfshirë këtu piketat dhe afatet kohore, me propozimet respektive për masa ligjore, ekonomike, sociale e të tjera për të parandaluar dhe zbutur pasojat potenciale negative. Këto dokumente duhet të analizojnë aspektet sociale, energjitike, dhe ekonomike të dekarbonizimit dhe të identifikojnë mundësitë për zgjidhjen e konfliktit midis sigurisë energjitike, objektivave klimatike dhe elementeve social përfshirë dhe mundësitë për krijimin e vendeve të punës dhe për parandalimin e rritjes së kostove të energjisë elektrike dhe përkeqësimit në këtë mënyrë të problemeve të varfërisë energjitike.

Gjatë zhvillimit të PVEQ-së, Komitetet e Dekarbonizimit duhet të marrin në konsideratë dhe të përlogarisin pasojat që mund të ketë Mekanizmi i Përshtatjes Kufitar të Karbonit (MPKK) tek konkureshmëria dhe veprimtaria e përgjithshme ekonomike për secilën ekonomi të Ballkanit Perëndimor. Këto vlerësime të impaktit të MPKK-së duhet të përgatiten nga KD-të deri në fund të vitit 2023 dhe t'u paraqiten autoriteteve të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimet e përgatitura të impaktit duhet të paraqesin gjithashtu edhe të dhëna nga procesi i harmonizimit me Sistemin e BE-së për Tregtimin e Emetimeve (STE) ose të prezantojnë instrumente të tjerë për çmimin e karbonit. Ato do të shërbejnë gjithashtu si një mjet i dobishëm për përcaktimin e një orientimi strategjik në zhvillimin apo finalizimin e Planeve Kombëtare për Energjinë dhe Klimën (PKEK-të).

Rishikimi i legjisllacionit përkatës të klimës në Ballkanin Perëndimor duhet të jetë një nga prioritetet në vitet e ardhshme për të mbështetur dekarbonizimin progresiv dhe për të garantuar ekuilibrin mes synimeve, çmimeve, standardeve dhe masave mbështetëse, si dhe harmonizimin e plotë me Ligjin e BE-së për Klimën, deri nga fundi i vitit 2023.

Deri në vitin 2026, duhet përgatitur Strategjia Rajonale e Ballkanit Perëndimor për Përshtatjen (SRP) me qëllim formulimin e nevojave të përbashkëta, përcaktimin e veprimtarive të përbashkëta për rritjen e qëndrueshmërisë rajonale klimatike dhe identifikimin e burimeve financiare potenciale. Strategjia duhet të ofrojë propozimin për nxitjen e qëndrueshmërisë klimatike në rajon deri në vitin 2030 me vizionin afatgjatë

për një rajon Ballkani Perëndimor të qëndrueshëm ndaj klimës dhe të përshtatur për t'i bërë ballë impaktit të pashmangshëm të ndryshimeve klimatike deri në vitin 2050. Strategjia duhet të jetë në përputhje me Strategjinë e BE-së për Përshtatjen, Planet Kombëtare të Përshtatjes dhe dokumente të tjera me rëndësi dhe duhet të eksplorojë mundësi për të zgjeruar zbatimin e zgjidhjeve mbi baza natyrore me synim rritjen e qëndrueshmërisë klimatike.

Për të arritur neutralitetin e klimës deri në vitin 2050, reduktimi i emetimeve të GS-së duhet të shoqërohet me rritjen e eliminimit të karbonit. Në këtë aspekt, harmonizimi me Rregulloren e rishikuar për përfshirjen e emetimeve të gazrave serrë dhe eliminimin nga përdorimi i tokës, ndryshimet e përdorimit të tokës dhe pylltaria (PTNPTP) dhe zbatimin i saj duhet të jetë një nga prioritetet e rajonit për dhjetëvjeçarin e ardhshëm. Përmirësimi i inventarizimit të GS-ve, zhvillimi i Planeve të Inventarizimit të Pyjeve (i cili përmban një nivel reference të propozuar pyjesh, në përputhje me Rregulloren PTNPTP) duke shtuar kështu kategori të reja të produkteve të depozitimit të karbonit, përfshirë këtu produkte me bazë lënde drusore, duhet të përbëjë hapat e parë drejt përbushjes së këtij qëllimi. Përveç kësaj dhe kapacitetit të sektorit të PTNPTP-së për të thithur karbonin nga atmosfera, ka një nevojë të ngutshme për një qasje të integruar ndaj politikës së klimës dhe për një kontribut më të madh nga sektori i tokës përfshirë këtu optimizimin e planifikimit dhe praktikave të përdorimit të tokës. Për më tepër, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të krijojnë një kuadër të përshtatshëm për maksimizimin e sekuestrimit të karbonit dhe duhet të zhvillojnë protokollat, mjetet dhe mekanizmat e duhur për monitorimin, raportimin dhe verifikimin e sekuestrimit të karbonit. Gjatë rishikimit të parë të këtij PV (planifikuar për vitin 2024), duhet të përcaktohet një indikator i përshtatshëm për të plotësuar sistemin e monitorimit, e bashkë me këtë indikator, edhe metodologjia e mbledhjes dhe llogaritjes së të dhënave në përputhje me kërkesat dhe orientimet e Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet

Klimatike (PNNK) dhe të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (KKKBNK).

Nisma e Paktit Europian të Klimës duhet të promovohet përmes angazhimit, bashkërendimit dhe trajnimit të Ambasadorëve të Paktit të Klimës nga rajoni për t'i ndihmuar ata në përpjekjet e tyre, për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm dhe për të motivuar sa më shumë individë dhe organizata që të bëhen pjesë e nismës, të marrin angazhimet e tyre dhe të japin ndihmesën e tyre në përbushje të qëllimeve të përbashkëta dhe të përfitojnë nga arritjet në të ardhmen. Përveç kësaj, për të nxitur bashkëpunimin rajonal, shkëmbimin e njohurive dhe praktikave më të mira në të gjitha nivelet, duhet të nisë funksionimin Qendra e Ballkanit Perëndimor për Informacione mbi Klimën, lidhur kjo me bazën e të dhënave "Climate-ADAPT" e të tjera si kjo.

Për të mbështetur dhe lehtësuar tranzicionin e gjelbër, të parashikuar e të ndërlikuar, duhet përgatitur Programi Rajonal për Ngritjen e Kapaciteteve për të mbështetur autoritetet dhe organizatat në të gjitha nivelet (përfshirë sektorët lokalë dhe privatë) për të zhvilluar kapacitetet e nevojshme për zbutjen, përshtatjen, reduktimin e rrezikut të katastrofave dhe dekarbonizimin.

Plani i Veprimtarive për Energjinë

Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor po përballen me dy sfida kryesore. Së pari, duhen përbushur detyrimet ekzistuese prej kohësh si krijimi i tregjeve konkurrues dhe të integruar të energjisë në përputhje me rregulloret më të fundit. Së dyti, me vjeljen e frutave në degët më të ulta si në aspektin e politikave ashtu edhe në atë të angazhimeve (të paktën përveç efikasitetit energjitike), zbatimi i reformave ka për të qenë mjaft i vështirë, dhe kjo do të ndodhë në kushtet e një mjedisi rregullator dinamika e të cilit ndryshon

vazhdimisht. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk duhet vetëm të përmirësojnë normën e zbatueshmërisë së detyrimeve të tyre aktuale, por duhet në të njëjtën kohë, të përshtaten me ndryshimet e paradigmes që ndodhin në BE në të gjitha fushat, qoftë ajo e energjisë, transportit, apo politikave të klimës, dhe të integrojnë objektivat e tyre më të fundit në kuadrin e tyre ligjor dhe të politikave për të garantuar kështu përmbushjen e neutralitetit të klimës deri në vitin 2050. Sektorit energjistik të Ballkanit Perëndimor, që bazohet shumë tek karburantet fosile, teknologjitë dhe impiantet e vjetëruara, i takon të luajë një rol të rëndësishëm. Duke qenë tashmë një proces i ndërlikuar dhe i vështirë, ai i transformimit dhe integritit të Ballkanit Perëndimor në tregun energjistik të BE-së, ai nis të sprovohet edhe më shumë duke patur parasysh afatet e ngutshme të angazhimeve dhe kërkesave të reja të dekarbonizimit për një transformim rrënjësor të sektorit në fjalë.

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Mbetet prioritet zbatimi i detyrimeve aktuale dhe respektimi i angazhimeve dhe ambicjeve ekzistuese sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Nëse nuk krijohet një bazë e qëndrueshme, nuk mund të gjejë zbatim prezantimi i objektivave dhe rregullave më të fundit të cilat parashikohen nga AGJE-ja. Kjo do të thotë se ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të vazhdojnë të zbatojnë dispozitat e përcaktuara të Paketës së Tretë të Energjisë dhe të Paketës së Energjisë së Pastër në sektorët e energjistikës dhe gazit përfshirë këtu krijimin e tregjeve funksionale, me platformat e tregëtimit dhe furnizime të bollshme.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor duhet gjithashtu të vazhdojë përpjekjet për të rritur dhe diversifikuar sasinë e energjisë së rinovueshme në konsumin bruto të energjisë, si dhe për të ngritur dhe zbatuar skema ekonomike të qëndrueshme mbështetjeje dhe për të nxitur vetë-konsumin e energjisë nga burime të rinovueshme. Arritja e objektivave

të efikasitetit të energjisë, përfshirë dhe rinovimin e ndërtesave, duhet të vazhdojë po ashtu por në mënyrë sistematike dhe të përshtetshme.

Kufizimi i emetimeve nga impiantet e mëdha të djegies vazhdon të përbëjë një nga sfidat më të mëdha për rajonin. Për këtë arsye, duhet të gjejë zbatim të plotë Rregullorja e Qeverisjes dhe zhvillimi i PKEK-së së integruar. Zgjerimi i acquis-ve të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për të përfshirë edhe klimën dhe mjedisin përbën një hap të rëndësishëm drejt kalimit në një shoqëri me nivele të ulëta karboni, me efikasitet në energji dhe e bazuar tek burimet e rinovueshme në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Detyrimet ekzistuese për transformimin e sistemit energjistik të Ballkanit Perëndimor duhet të plotësohen me ambicie të reja për të përshtetshme transformimin dhe për të garantuar dekarbonizimin e sektorit energjistik. Prandaj, dhe aty ku shihet e nevojshme, duhet të merret vendim politik për paraqitjen e çmimit të karbonit në periudha afatshkurtra dhe të një sistemi të duhur tregtimi emetimesh në periudha afatmesme dhe afatgjata për secilën ekonomi të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, rajoni duhet të përcaktojë një datë të qartë dhe proces të detajuar për eliminimin e prodhimit të energjisë bazuar tek linjtet (aty ku gjen zbatim). PKEK-ja dhe KD-ja mund të luajnë një rol të rëndësishëm në këtë proces.

Për të bërë të mundur monitorimin e progresit dhe vendim marrje të mirëinformuar, rajoni i Ballkanit Perëndimor duhet të bëjë përpjekje të tjera për të institucionalizuar inventaret e tyre të emetimit dhe regjistrat e emetimit të GS, dhe për të zhvilluar mekanizmat e duhur monitories, raportues dhe verifikues. Jo më pak i rëndësishëm, duhet të vazhdojë dhe të përshtetshmet procesi i zhvillimit të PKEK-në përfundim me paraqitjen KPK2.

Këshilli Ministerial i Komunitetit të Energjisë duhet të përcaktojë dhe të miratojë sa më shpejt objektivat 2030 për emetimet e GS-ve, sasinë e energjisë së rinovueshme dhe përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Për të mbështetur arritjet e tyre, bashkë me elemente të tjera, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të përgatisin strategji afatgjata për rinovimin e ndërtesave në mbështetje të kalimit në ndërtesa

të dekarbonizuara dhe me efikasitet të lartë energjike në përputhje me nismën e Komisionit Europian për Valën e Rinovimit.

Kalimi i pritshëm në klimën dhe energjinë e gjelbër në rajon do të kishte nevojë për përmirësim të kuadrit ligjor përkatës përmes transpozimit të dispozitave të reja që vijnë nga AGJE-ja përmes paketës "Fit for 55", si dhe akteve të tjera legjislative dhe jo legjislative, siç parashikohen në Planin e Veprimtarive të Komunitetit të Energjisë për Dekarbonizimin.

Plani i veprimtarive për Transportin e Qëndrueshëm

Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Sektori i transportit është një nga burimet kryesore të emetimeve të GS-ve (dhe emetimeve të NOx) në rajon dhe së bashku me sektorin e energjisë përfaqësojnë dy të tretat e sasisë totale të emetimeve. Në vitin 1990, sasia e emetimit të sektorit të transportit ishte 12%, ndërsa në vitin 2012 ato u rritën në 18%. Rritja e emetimeve vazhdon paralelisht me veprimtaritë ekonomike, ndërsa kontributi i sektorit të transportit vjen nga pesë nënsektorë: transporti rrugor, hekurudhat, aviacioni, transporti detar dhe ai i brendshëm ujor. Sasia në total e emetimeve nga transporti dominohet nga CO₂ nga transporti rrugor (më shumë se 90%), që manifestohet në zonat e mëdha urbane të cilat vuajnë dhe nga nivele më të larta ndotjeje.

Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit (SPKT-ja) së bashku me partnerët rajonalë kanë zhvilluar një Strategji Lëvizshmërie të Qëndrueshme dhe Inteligjente për Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i kësaj Strategjie është: i) të pasqyrojë Strategjinë e Bashkimit Europian për Lëvizshmëri të Qëndrueshme dhe Inteligjente; ii) të përshtasë qëllimet, etapat dhe veprimet në realitetin e Ballkanit Perëndimor; dhe iii) ta pajisë rajonin me një plan veprimtarish dekarbonizimi dhe digjitalizimit për sektorin e

vet të transportit dhe t'i asistojë partnerët rajonalë në hartimin e strategjive të tyre kombëtare. Strategjia parashtron objektiva ambiciozë në tre fusha kryesore: Lëvizshmëri e Qëndrueshme, Inteligjente dhe e Palëkundur, si dhe objektiva të përbashkëta rajonale me një plan veprimtarish dhe grup veprimesh të cilat ftohen t'i zbatojnë të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Theksi vihet tek veprimet afatshkurtra dhe afatmesme për të rritur nivelin e digjitalizimit dhe gjelbërimit të lëvizshmërisë në rajon dhe për ta bërë transportin më të gjelbër, më të qëndrueshëm dhe më të shëndetshëm për qytetarët e Ballkanit Perëndimor.

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Lëvizshmëria inteligjente parashikon integrimin e teknologjive digjitale dhe të automatizimit në sistemet e transportit me qëllim rritjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së lëvizshmërisë së pasagjerëve dhe mallrave. Ky koncept i ri i transportit është një nga tre komponentët e Strategjisë së Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe Inteligjente për Ballkanin Perëndimor. Për të zbatuar këtë strategji, ekonomitë në rajon duhet t'i transformojnë sektorët e tyre të transportit duke aplikuar biletat multimodale, lëvizshmërinë si shërbim, transportin pa shkresa dhe shfrytëzimin e programeve të ndryshme software, apo rrjetin 5G dhe inteligjencën artificiale për optimizimin e veprimtarive të transportit. Strategjia parashikon gjithashtu krijimin e kuadrit dhe partneriteteve bashkëpunuese brenda rajonit dhe me VA-të të BE-së për të nxitur inovacionin dhe shfrytëzimin e teknologjive novatore.

Këshilli Ministerial i TKT-së ka miratuar Planin e Veprimtarive Hekurudhor në tetor të vitit 2020. Ai përbën një plan hapash për të gjitha reformat dhe projektet që duhen materializuar për ta sjellë hekurudhën në binarë dhe përbëhet nga pesë shtylla: hapja e tregut; të drejtat e pasagjerëve; operacione të lehtësimit të tregut/përmirësimi i pikave të kalimit kufitar/pika të përbashkëta të kalimit; ndëroperacionaliteti; dhe modernizimi i infrastrukturës. Përmes zbatimit të tij, ekonomitë e Ballkanit duhet të forcojnë rolin e sektorit hekurudhor, të mbështesin multimodalitetin dhe të ulin varësinë nga transporti rrugor, duke patur kështu një efekt zvogëlues tek emetimet. Duke ia njohur potencialin

këtij Plani Veprimi si një instrument për modernizimin e hekurudhave në rajon, me rastin e Samitit të Hekurudhave të Ballkanit Perëndimor (shtator 2021), Ministrat e Transportit të Ballkanit Perëndimor nënshkruan deklaratën e përbashkët e cila konfirmon angazhimet e tyre për të modernizuar sistemin hekurudhor. Mes objektivave të tjera, deklarata përfshin zhvillimin e linjave ndërqytetëse me tren ekspres mes qyteteve të mëdha, digjitalizimin e sistemeve hekurudhore, përmirësimin e multimodalitetit dhe të sigurisë së transportit hekurudhor në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Rrjeti Bazë dhe Gjithëpërfshirës TEN-T është përkufizuar në Shtojcën I të Traktatit të Komunitetit të Transportit. Procesi i rishikimit të TEN-T në nivel europian është ende në zhvillim e sipër. Rishikimi do të përfshijë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. SPKT-ja do të bashkërendojë veprimtaritë mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe Vendeve fqinje Anëtare të BE-së, së bashku me KE-në për të mbështetur transformimin e sektorit të transportit në Ballkanin Perëndimor.

Transporti rrugor është një mënyrë dominuese e transportit në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe një kontribues i konsiderueshëm në emetimin e GS-ve dhe ndotjes së ajrit. Duke ndjekur shembujt e parashtruar në Strategjinë e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe Inteligjente për Ballkanin Perëndimor, rajoni do të rrisë numrin e mënyrave më të qëndrueshme të transportit, do të mbështesë multimodalitetin dhe gradualisht do të ulë dhe shkurajojë përdorimin e transportit rrugor, gjë që do të kontribuojë në reduktimin e emetimeve dhe në tranzicionin e gjelbër.

Plani i Veprimit për Lehtësimin e Transportit i miratuar nga Këshilli Ministerial i TKT-së në tetor të vitit 2020 parashikon veprime për Pikat e Kalimit Kufitar (PKK-të) dhe përcakton masat që synojnë heqjen e barrierave jo-fizike përgjatë korridoreve kryesore të transportit në Ballkanin Perëndimor dhe duke e lidhur atë me VA-të e BE-së. Plani i Veprimit parashikon modernizimin dhe përmirësimin e kapaciteteve në PKK-të e brendshme dhe shfrytëzimin e teknologjive dhe pajisjeve digjitale për përmirësimin e menaxhimit të kufirit me qëllim krijimin e operacioneve të përbashkëta kufitare dhe

kontrolle me një ndalesë. I tërë koncepti do të lehtësojë veprimtaritë e transportit në Ballkanin Perëndimor dhe do të reduktojë ndikimin e tij negativ në mjedis dhe klimë.

Plani i Veprimit për Sigurinë Rrugore është një tjetër dokument strategjik i miratuar nga Këshilli Ministerial i TKT-së në tetor të vitit 2020. Ky Plan Veprimi promovon menaxhimin e sigurisë, infrastrukturën më të sigurtë dhe mbrojtjen e përdoruesve të rrugës. Veprimet e këtij plani synojnë të mbështesin objektivin e zero vdekje dhe të inkurajojnë praktikën më të mira rajonale. Zbatimi i Planit të Veprimit do të monitorohet nga SPKT-ja përmes Komitetit Teknik të Sigurisë Rrugore.

Plani i Veprimit për Rrugët, miratuar gjithashtu në Këshillin Ministerial TKT-së në tetor të vitit 2020 synon të zhvillojë në rajonin e Ballkanit Perëndimor një rrjet rrugor TEN-T inteligjent, i qëndrueshëm ndaj klimës, dhe eficient për nga burimet, duke integruar elemente të gjelbra dhe inteligjente në investimet rrugore. Synimi përfundimtar është të stimulojë operacione novatore të transportit rrugor të cilat janë të përshtatshme për epokën digjitale. Dokumenti ofron një listë veprimtarish afatshkurtra dhe afatmesme që ka si qëllim trajtimin e çështjeve si mirëmbajtja e rrugëve, pagesa e kalimit të rrugës, shfrytëzimi i sistemeve inteligjente të transportit, qëndrueshmëria e rrjetit dhe përdorimi i karburanteve alternative. Të gjitha masat e identifikuar duhet të mbështesin kalimin e gjelbër të sektorit të transportit dhe do të mbështesin reduktimin e emetimeve dhe ndotjes që lidhen me të.

Është njohur rëndësia e qëndrueshmërisë klimatike të infrastrukturës së transportit. Megjithatë, asnjë nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk e ka përgatitur apo nuk ka miratuar strategji që synojnë sektorin e transportit për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike. Plani i Veprimit për Rrugët parashikon përgatitjen e një vlerësimi të ndryshimeve klimatike me udhëzimet në nivel rajonal si një mekanizëm për të rritur qëndrueshmërinë e klimës së rrjetit të transportit në rajon.

Rreth 25 qytete në Ballkanin Perëndimor kanë kohë që vuajnë nga ndotja që i kapërcen vlerat e pranuar. Ndotës të dëmshëm kanë pasoja negative jo vetëm tek shëndeti

i njerëzve por në tërë ekonominë, si rritja e kostove të sistemit shëndetësor dhe mungesat e shpeshta nga puna. Edhe pse transporti urban është nën juridiksionin e qeverisë lokale, politikat ekzistuese për transportin dhe mbështetja financiare duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mund të reflektojnë rëndësinë e lëvizshmërisë urbane për funksionimin në tërësi të TEN-T. Për këtë arsye, ashtu siç dhe parashikohet në Strategjinë e Lëvizshmërisë së Qëndrueshme dhe Inteligjente, SPKT-ja do t'i mbështesë ekonomitë e Ballkanit Perëndimor për të çuar para "gjelbërimin" e transportit të tyre, për të promovuar dhe asistuar, nëse shihet si e nevojshme, në krijimin e planeve të qëndrueshme të lëvizshmërisë urbane.

Shfrytëzimi në shkallë të gjerë i karburanteve alternative në sektorin e transportit has disa pengesa si për shembull: kërkesa e ulët për karburante dhe automjete të qëndrueshme; mungesa e incentivave, mungesa e një rrjeti të qëndrueshëm rifurnizimi/rikarikimi dhe kufizime në ofertë. Në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, derivatet e naftës përbëjnë llojin dominues të karburantit që përdoret për transport. Për të zgjidhur qasjen e pakoordinuar për zhvillimin e infrastrukturës së karburanteve alternative (stacione furnizimi dhe karikimi), ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të mundësojnë zhvillimin e një rrjeti gjithëpërfshirës në përputhje me standardet dhe kërkesat e ndëroperacionalitetit të BE-së. Ky rrjet do të mundësonte përdorimin, në rajon, të automjeteve me emetim të ulët apo zero.

Shfrytëzimi i infrastrukturës së karburanteve alternative përbën një çështje që prek dhe ndikon autoritete të ndryshme (të energjisë, transportit, etj) apo organizata të ndryshme rajonale (SKPT-ja, SKEn-ja, KBR-ja) të cilat mund të luajnë një rol. Për të shmangur mbivendosjen dhe për të inkurajuar sinergjitë, duhet krijuar një qasje e bashkërenduar për të mbështetur ekonomitë e Ballkanit Perëndimor në përpjekjet e tyre për të përdorur karburantet alternative dhe për të zhvilluar një infrastrukturë e duhur të nevojshme për reduktimin e varësisë nga karburantet fosile dhe për zvogëlimin e emetimeve dhe ndotjes që vijnë si rezultat i tyre. SPKT-ja, SKEn-ja dhe KBR-ja duhet të bashkojnë forcat

dhe të bashkërendojnë veprimtaritë për të ndarë njohuritë dhe përvojat, e në këtë mënyrë të ngrenë kapacitetet për të mbështetur rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Plani i Veprimtarive për Ekonominë Qarkulluese

Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Në Ballkanin Perëndimor, progresi i harmonizimit të legjislaconit për menaxhimin e mbetjeve, përfshirë riciklimin, plastikën, kimikatet, dizenjimet ekologjike si dhe dispozita të tjera që lidhen me ekonominë qarkulluese është mjaft i ngadaltë dhe i kufizuar, ndërsa zbatimi i plotë i kuadrit ekzistues ligjor dhe të politikave përbën një sfidë edhe më të madhe.

Koncepti i ekonomisë qarkulluese (EQ) është një koncept i ri për rajonin, dhe për këtë arsye vazhdon të jetë abstrakt për shumë nga qytetarët dhe pronarët e kompanive të Ballkanit Perëndimor. Rajoni ka potencialin për t'u përfshirë dhe për t'u zhvendosur drejt ekonomisë qarkulluese por kjo do të jetë e mundur vetëm duke vendosur objektivat e EQ-së në qendër të fushave të politikave dhe duke i integruar praktikat e EQ-së në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe në të gjitha nivelet, e në të njëjtë kohë duke rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm për konceptin në fjalë dhe përfitimet që mund të sjellë.

Manaxhimi i mbetjeve dhe riciklimi, si shtyllat kryesore të konceptit të EQ, vazhdojnë të dominohen nga një qasje lineare e tipit "mblidh dhe hidh" e nuk bazohen në një sistem të integruar e të qëdrueshëm menaxhimi mbetjesh bazuar tek forma qarkore. Rajonit i nevojitet vendosmëria e politikanëve dhe vendimmarrësve, një kuadër ligjor dhe politikash i fortë dhe mundësues, fushata ndërgjegjësimi dhe incentiva ekonomike dhe financiare për të nxitur kalimin në ekonominë e gjelbër. Kuadri i ri i politikave i zhvilluar sipas AGJE-së, përfshirë këtu Planin e ri të Veprimit për Ekonominë Qarkulluese, Strategjinë e re Industriale për Europën dhe legjislaconin për mbetjet dhe

emetimet industriale që i nënshtrohet rishikimit³, së bashku me nismat për prodhimin e çelikut me zero karbon, dhe produktet qarkulluese e neutrale ndaj klimës ofrojnë një orientim strategjik drejt neutralitetit të karbonit, jo vetëm për BE-në por edhe për Ballkanin Perëndimor. Sa më shpejt të ndërmerret kjo nismë, aq më shumë mundësi ka të shfrytëzohet potenciali i konsiderueshëm ekonomik dhe të arrihen përfitimet mjedisore.

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Në përpjekjet që ndërmerr për përmbytjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050, Ballkani Perëndimor duhet të përcaktojë një kuadër gjithëpërfshirës për kalimin në EQ përmes zhvillimit dhe përvetësimit të Strategjive mbarë ekonomike të Ekonomisë Qarkulluese deri në vitin 2023. Përveç kësaj ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të zhvillojë/përditësojë Planet e Veprimtarive për Ekonominë Qarkulluese brenda të njëjtës periudhë. Këto dokumente duhet të parashtrojnë një numër rezultatesh dhe afatet që nevojiten për zbatim. Aty do të përcaktohet edhe kuadri i nevojshëm për kalimin e shpejtë në ekonominë qarkulluese duke integruar objektivat e AGJE-së dhe duke mbyllur boshllëqet në procesin e harmonizimit me acquis-të ekzistuese të BE-së. Për më tepër, ato duhet të identifikojnë faktorët kyç shtytës, mundësitë dhe pengesat, sektorët prioritarë dhe kapacitetet apo organizamt e nevojshëm administrative që do të bashkërendojnë zbatimin e tyre.

Në fazën fillestare të zbatimit të Deklaratës së Sofjes, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të përqendrohen në promovimin dhe heqjen e pengesave për përdorim më të gjerë të materialeve dhe produkteve bazë qarkulluese dhe neutrale ndaj klimës, duke u përqendruar tek hekuri, çeliku, çimentoja, mineralet jo metalike, kimikatet dhe alumini bazik. Këtu mendohet të nxitet kërkesa dhe zhvillimi i tregjeve për produkte të tilla, duke përmirësuar infrastrukturën e nevojshme, duke shfrytëzuar teknologjitë më të fundit por gjithashtu duke rritur besimin e qytetarëve dhe bizneseve tek materialet dhe produktet e ricikluara përmes ofrimit të informacionit të duhur dhe të besueshëm në

lidhje me cilësinë dhe emetimet përkatëse, duke prezantuar standardet dhe etiketat e gjelbra për produktet në fjalë.

Strategjitë e parashikuara që do të përfshijnë mbarë ekonominë, si dhe Planet e Veprimtarive, do të ofrojnë një vizion dhe plane për krijimin e një mjedisi mundësues për materialet dhe produktet qarkulluese dhe neutrale ndaj klimës për të stimuluar kështu kërkesën dhe për të garantuar disponueshmërinë dhe leverdishmërinë e tyre përmes reduktimit të çmimit si pasojë e ekonomive të shkallës. Këto plane duhet të trajtojnë gjithashtu çështje si produktiviteti i burimeve duke përfshirë modele të reja biznesi, përdorim efikas të burimeve (materiale dhe energjie), cikle të gjata jete, konsum të qëndrueshëm (përfshirë prokurimin e gjelbër publik[→]), trajtimin e duhur në fund të fazës së përdorimit të produkteve, si dhe menaxhimin e mbetjeve. Këto plane duhet të gjurmojnë hapat e mëtejshëm drejt përmirësimit të qëndrueshmërisë së prodhimit parësor të lëndës së parë dhe duke i kthyer produktet e qëndrueshme në normë në Ballkanin Perëndimor.

Deri në vitin 2025, të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të integrojnë objektivat e Strategjisë së re Industriale për Europën dhe të transpozojnë elementet e tjerë të kuadrit ligjor dhe të politikave të nevojshëm për integrimin e parimeve të ekonomisë qarkulluese në sektorin e industrisë. Parakushti i pare për arritjen e neutralitetit të klimës deri në vitin 2050 do të jetë reduktimi në mënyrë të vazhdueshme dhe të konsiderueshme i emetimeve nga impiantet e çelikut, çimentos dhe ato kimike. Vetëm përmes reduktimit të emetimeve, rajoni do të jetë në gjendje të shmangë pasojat potencialisht negative të Mekanizmit të Rregullimit Kufitar të Karbonit (MRRKK), dhe rrezikun e humbjes në konkurueshmëri në tregun e BE-së apo rrezikun e të qenurit i bllokuar në teknologji konvencionale dhe të vjetëruara të bazuara në karbon. Transformimi i sektorit të industrisë ka nevojë të ecë me të njëjtin hap me transformimin e sektorit të energjisë përfshirë shfrytëzimin në shkallë të gjerë të energjisë së rinovueshme dhe hidrogjenit të pastër si faktorë kyç që mundësojnë

³ Përfshirë rregulloret për bateritë, automjetet e amortizuara, landfillet, etj.

transformimet e pritshme industriale. Neutraliteti i karbonit në Ballkanin Perëndimor nuk mund të ndodhë pa një transformim të parashikueshëm të sektorit të industrisë, pa reduktimin e konsiderueshëm të karbonit dhe formën qarkore të gjurmimit dhe shtrirjen e materialeve në tërë ekonominë.

Përveç progresit të kufizuar në harmonizimin me acquis-të e BE-së për menaxhimin e mbetjeve, implementimi dhe zbatueshmëria e legjislacionit ekzistues për mbetjet paraqesin probleme të mëdha. Strategjitë dhe Planet e parashikuara të Veprimtarive duhet të zhvillojnë plane, të identifikojnë modele dhe mekanizma mbështetës (subvencione, instrumente financiare, modele partneriteti publik-privat) për të mbështetur ndërtimin dhe siguruar mirëmbajtjen e duhur të infrastrukturës së menaxhimit të mbetjeve për qytetet dhe rajonet. Këto plane duhet të harmonizohen me legjislacionin e rishikuar të mbetjeve në BE dhe duhet të përqendrohen në reduktimin e gjenerimit të mbetjeve, rritjen e mbledhjes së diferencuar dhe riciklimin, dhe stimulimin e modeleve të sipërmarrjes qarkulluese. Vëmendje e veçantë duhet t'i jepet trajtimit të mbetjeve të baterive, tekstileve, pajisjeve elektrike dhe elektronike (MPPE). Për më tepër, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të përcaktojnë objektiva në përputhje me BE-në për përgatitjen për ripërdorim/riciklim të mbetjeve bashkiake deri në vitin 2035, të vendosin objektiva ambiciozë në përputhje me BE-në dhe që përfshijnë mbarë ekonominë për paketimin e mbetjeve, për MPPE, si dhe për automjetet dhe bateritë jashtë përdorimit.

Nisja e kalimit në ekonominë qarkulluese në rajon kërkon rritjen e ndërgjegjësimit për mundësitë dhe përfitimet e qasjes së re dhe për paradigmat e ndryshuara të prodhimit dhe konsumit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2022, duhet të nisë një fushatë rajonale, e fokusuar në zinxhirët kryesorë prodhues të identifikuar në Ballkanin Perëndimor dhe duke synuar kështu fuqizimin e konsumatorëve, pronarëve të bizneseve, blerësve publik, dhe duke përmirësuar njohuritë mbi aspekte të EQ në nivele të ndryshme. Fushata duhet të ketë si bosht të vetin sigurimin që konsumatorët të marrin informacionin e dobishëm dhe të besueshëm për produktet (jetëgjatësinë, mundësinë për ta riparuar,

përdorimin e burimeve, trajtimin dhe riciklueshmërinë) për zhvillimin e një modeli që do të parandalonte ekzagjerimet në informacione mjedisore dhe pretendimet e kompanive për respektimin e mjedisit dhe për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me kërkesat për logot dhe etiketat e qëndrueshmërisë. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet prokurimit të gjelbër – integrimin e kërkesave të gjelbra në procedurat e prokurimit publik dhe të konceptit të zgjeruar të përgjegjësive së prodhuesit. Fushata duhet të promovojë një model të ri konsumi mes qytetarëve dhe bizneseve të Ballkanit Perëndimor, duhet të nxisë modelet e konsumit inteligjent, të minimizojë sjelljen konsumistike dhe të promovojë ruajtjen e burimeve në ekonomi sa më gjatë të jetë e mundur. Për më tepër, fushata duhet të përfshijë orientimet/udhëzimet për autoritetet e Ballkanit Perëndimor të cilat lëshojnë leje për impiante industriale, me shembuj praktikash më të mira dhe rekomandimet përkatëse mbi atë se si të merren në konsideratë parimet e ekonomisë qarkulluese dhe të inkurajohen investitorët se si t'i zbatojnë ato, duke përmirësuar disponibilitetin e burimeve si dhe efikasitetin e prodhimit dhe shpërndarjes.

Zgjidhja e problemit të plastikës, përfshirë ndotjen nga mikro-plastika, dhe trajtimi i ndotjes detare kërkon një qasje të bashkërenduar në nivel rajonal. Programi i Partneritetit Mjedisor për Aderim (PPMA) do të kontribuojë në përgatitjen e një marrëveshjeje rajonale për ndotjen detare. Finalizimi dhe nënshkrimi i marrëveshjes pritet deri në fund të vitit 2022.

Ballkani Perëndimor duhet të vazhdojë me përgatitjen dhe zbatimin e Strategjive Inteligjente të Specializimit, përfshirë zhvillimin e një mekanizmi për novacionin mbështetës në fushën e ERR-së për të mundësuar tranzicionin e shpejtë drejt modeleve të reja biznesi miqësore ndaj mjedisit dhe produkteve neutrale ndaj klimës, dhe për të përmirësuar konkureshmërinë e ekonomisë.

Plani i Veprimtarive për Eliminimin e Ndotjes

Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Popullata e Ballkanit Perëndimor është e ekspozuar ndaj disa prej përqëndrimeve më të larta të ndotjes së ajrit në Europë. Ndotja paraqitet në nivele deri pesë herë më të larta se nivelet e parashikuara në udhëzimet e BE-së⁴. Arsyet kryesore janë përdorimi në shkallë të gjerë i karburanteve të ngurta të cilësisë së ulët, lehtësirat industriale dhe automjetet e vjetra e jashtë standardit, sasi të mëdha energjie e prodhuar nga impiante energjie termale (me qymyr), emetimet nga impiante të mëdha djegieje, si dhe ngrohja në shtëpi. Karburantet e ngurta (qymyri dhe dru për djegie) përdoren për ngrohjen e shtëpive nga rreth 60% e populates. Vetëm 12% e ndërtesave në Ballkanin Perëndimor lidhen me sisteme qendrore ngrohjeje⁵. Të gjitha ekonomitë e Ballkanit Perëndimor e monitorojnë cilësinë e ajrit në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe ia raportojnë të dhënat Rrjetit European i Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor (RREIVM). Sistemet e Ballkanit Perëndimor për monitorimin e ajrit hasin vështirësi në lidhje me të dhëna inkonsistente si pasojë e mungesës së burimeve financiare që nevojiten për mirëmbajtjen e stacioneve, mungesës së laboratorëve të certifikuar të kalibrit dhe mungesës së modelimit të cilësisë së ajrit. Pavarësisht numrit të madh të stacioneve monitoruese të cilësisë së ajrit në Ballkanin Perëndimor, si pasojë e instalimeve të

pamjaftueshme dhe mungesës së fondeve që nevojiten për kostot e funksionimit dhe mirëmbajtjes, cilësia e të dhënave vazhdon të mos jetë në nivelin e dëshiruar.

Edhe pse Ballkani Perëndimor ka sasi relativisht të bollshme uji, vetë rajoni është i papërgatitur për ndryshimet klimatike, rrezikohet nga thatësira dhe përmbytjet, si dhe vuan mungesën e ujit të pijshëm në disa zona. Mungesat ndodhin më së shumti nga gjendja e keqe dhe e vjetëruar e rrjetit shpërndarës së ujit (me humbje prej 50%)⁶ dhe të sistemeve të filtrimit (mosfunksionim i trajtimit kimik dhe mikrobiologjik)⁷. Kjo çon gjithashtu në përkeqësimin e cilësisë së ujit në përgjithësi. Një përqindje e lartë e ujrave të ndotura po derdhet aktualisht në rrjedhat e ujit⁸, ndërsa cilësia e ujit të pijshëm po rëndohet si pasojë e gropave septike në zonat rurale të cilat nuk i plotësojnë kriteret, duke shkatërruar gjithashtu edhe cilësinë e tokës. Edhe pse vihen re disa përmirësime në lidhje me sektorin bashkiak të menaxhimit të ujrave të ndotura, ende vazhdon problem i trajtimit të ujrave të zeza (50-60%)⁹.

Uji që përdoret në bujqësi, më së shumti për ujitje, shkakton përkeqësim dhe kontaminim të mëtejshëm si pasojë e përdorimit të pesticideve jashtë standardeve. Mbi masat ujore është krijuar presion shtesë nga hovi i shpejtë i impianteve të vogla hidro-energjitike (IVHE). Cilësia e ujrave të pastra ndryshon në mënyrë të konsiderueshme në rajon, ku gjenden përrrenj malorë me ujë të kulluar dhe lumenj të ndotur nga ujrata industriale,

4 Ndotja e ajrit dhe shëndeti i njeriut: Rasti i Ballkanit Perëndimor, UNEP, 2019, [Air-Quality-and-Human-Health-Report_Case-of-Western-Balkans_preliminary_results.pdf](https://www.unep.org/air-quality-and-human-health-report-case-of-western-balkans-preliminary-results.pdf) (developmentaid.org)

5 Studimi Sektori për Ngrahjen e Bazuar tek Biomasa në Ballkanin Perëndimor, Grupi i Komunitetit të Energjisë dhe Bankës Botërore, 2017, Prezantim në formatin PowerPoint ([wbif.eu](https://www.wbif.eu))

6 Vëzhgim mbi vulnerabilitetin e ujit dhe ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor, Raporti Teknik ETC/ICM Technical Report 1/2018

7 Branko Vucijak, Mugdim Pasic, Izet Bijelonja, "Qëndrueshmëria financiare e njërive utilitare publike në Ballkanin Perëndimor" Revista Ndërkombëtare e Inxhinierisë XVI(3), 2018

8 Raport Teknik, Vëzhgim mbi vulnerabilitetin e ujit dhe ndryshimeve klimatike në Ballkanin Perëndimor ETC/ICM dhe partnerët e konsorciumit, 2018

9 EEA: <https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/daviz/changes-in-wastewater-treatment-in-13#tab-dashboard-01> dhe <https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/indicators/urban-waste-water-treatment/urban-waste-water-treatment-assessment-5>

urbanë dhe bujqësorë¹⁰. Legjislacioni i ujrave larës është në fazat e para të tij dhe vetëm disa, për mos të thënë fare pak, Direktiva të BE-së janë transpozuar për këtë çështje.

Në lidhje me token, sfida kryesore në Ballkanin Perëndimor është prishja e regjimit të tokës, që shfaqet më shumë si pasojë e rrëshqitjeve të dheut, erozionit, kontaminimit, bujqësisë së paqëndrueshme, transformimit të tokës dhe përdorimit të gabuar të tokës¹¹. Depozitimi nën standardin e kimikateve nga veprimtaritë industriale është një burim predominues i kontaminimit të dheut në rajon, ndërsa praktikatat e jashtëligjshme të hedhjes së tyre ende vazhdojnë. Mungesa e kapaciteteve të trajtimit për mbetjet e rrezikshme (grumbullimet, vendndodhjet e braktisura), veçanërisht në sektorët industrialë dhe minerarë, përfshirë përdorimin e pakontrolluar të pesticideve, çon në ndotjen e tokës (dhe ujrave nëntokësore). Ndryshimet më të përhapura për sa u përket kategorive të përdorimit të tokës në Ballkanin Perëndimor kanë qenë zgjerimi i sipërfaqeve artificiale (106 km²), pasuar nga zgjerimi i tokave për drithëra (65.7 km²), si dhe zvogëlimi i sipërfaqeve pyjore (21 km²) dhe kullotave (20.5 km²)¹².

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Disa nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor nuk e kanë ratifikuar Konventën për Ndotjen e Ajrit Ndërkufitar me Rreze të Gjatë dhe tetë protokollat e saj. Për këtë arsye, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të përcaktojnë afate për ratifikimin e Konventës dhe të nisin monitorimin dhe raportimin sistematik të emetimeve në ajër. Kjo do të krijojë kuadrin për menaxhimin e emetimeve dhe cilësinë e ajrit në të ardhmen dhe do të kontribuojë në ajër më të pastër në rajon.

Që nga 1 janari i vitit 2018, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë nisur reduktimin e emetimeve nga impiantet e mëdha të djegies. Ky proces bazohet në rregullat e

Komunitetit të Energjisë të cilat u kërkojnë impianteve të mëdha të djegies (përfshirë termocentralet me qymyr) të cilat aktualisht punojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që të ulin gradualisht emetimet e tyre deri në fund të vitit 2027 në përputhje me kërkesat minimale të Direktivës së Emetimeve Industriale (DEI). Një pjesë e madhe e përpjekjeve në Ballkanin Perëndimor duhet të përqëndrohen në investimet në kontrollin e ndotjes së ajrit, veçanërisht në impiantet e mëdha të djegies. Për të përmbushur efikasitetin e investimeve dhe për të maksimizuar përfitimet në shëndetin e njeriut, duhet të sigurohen pajisje të reja për kontrollimin e ndotjes në mënyrë që impiantet të mund të arrijnë e të përmbushin standardet më të fundit të BE-së¹³. Në këtë kontekst, në Ballkanin Perëndimor duhet bërë me urgjencë zbatimin e plotë të Planëve Kombëtare për Reduktimin e Emetimeve (PKRE) për impiantet e mëdha të djegies dhe zbatimin e DEI-së për të harmonizuar jo vetëm impiantet e mëdha të djegies po dhe të gjitha strukturat industriale me Teknikat më të Mira të Mundshme (TMM-të). Në përputhje me AGJE-në, Ballkani Perëndimor duhet të zhvillojë Programet Kombëtare për Kontrollimin e Ndotjes së Ajrit dhe të zbatojë angazhimet e reduktimit për të garantuar implementimin e plotë të Direktivës Kombëtare të Angazhimeve për Reduktimin e Emetimeve (AKE). Kështu, nevojitet progres për të përcaktuar dhe raportuar inventaret dhe projeksionet e emetimeve.

Për më tepër, duhen prezantuar standarde më të rrepta emetimi për automjetet, industrinë dhe sektorët e vegjël të cilat nuk mbulohen nga DEI. Ballkani Perëndimor duhet të ndjekë rishikimin e DEI-së dhe ta transpozojë atë, duke synuar përshpejtimin e përdorimit të novacionit zero ndotje, mbështetjen e dekarbonizimit industrial dhe ekonomisë qarkulluese dhe përmirësimin e aksesit publik ndaj informacionit, pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi. Monitorimi dhe inspektimet në përputhje me detyrimet ligjore që rrjedhin nga DEI janë mjaft të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes së cilësisë së ajrit. Në këtë kontekst, duhet inkurajuar zbatimin

10 Ballkani Perëndimor – Përmbledhje e Politikave Mjedisore dhe për Ndryshimet Klimatike, Pika informuese SIDA-s për Mjedisin dhe Ndryshimin Klimatik, 2012-11-30

11 Clindendael, Agjenda e Gjelbër: Dhënia e hapësirave me ajër për qytetarët e Ballkanit Perëndimor, 2021

12 ETC/ICM Raport Teknik 1/2018

13 <https://eippcb.jrc.ec.europa.eu/reference>

i legjislacioneve ekzistues për mbikëqyrjen dhe kontrollet e përputhjes me standardet së bashku me klauzolat e masave ndërkohë. Paralelisht duhen forcuar organizmat respektive të inspektimit.

Megjithëse kuadri legjislativ i cilësisë së ajrit në Ballkanin Perëndimor është gjerësisht i harmonizuar me legjislacioneve të BE-së, vazhdon të ketë vend për përmirësim. Ndotja e ajrit në Ballkanin Perëndimor duhet zgjidhur përmes veprimeve parandaluese dhe rimëkëmbëse, përfshirë rishikimin e standardeve të cilësisë së ajrit. Gjatë zbatimit të legjislacioneve të cilësisë së ajrit në Ballkanin Perëndimor duhet garantuar respektimi i vlerësimit dhe monitorimi i cilësisë së ajrit përmes sistemeve moderne dhe të zgjeruara të monitorimit, manaxhimi dhe raportimi për cilësinë e ajrit për t'iu përmbajtur standardeve të cilësisë së ajrit sipas Direktivës së Cilësisë së Ajrit në Mjedis. Për më tepër, dispozitat ligjore për planet e monitorimit, modelimit dhe cilësisë së ajrit duhen forcuar për të ndihmuar autoritetet lokale, ndërsa në të njëjtën kohë përmirësojnë zbatueshmërinë në tërësi të kuadrit rregullator. Në këtë kuptim, duhen eksploruar sinergjitet me Nismën e Komunitetit të Energjisë për Rajone me Ajër të Pastër. Për të patur një sistem plotësisht funksional monitorimi ajri, duhet të rritet, aty ku shihet si e nevojshme alokimi i burimeve financiare për mirëmbajtjen e stacioneve ekzistuese të monitorimit të cilësisë së ajrit dhe për instalimin e stacioneve të reja, duhet të certifikohen laboratorët e kalibrimit dhe duhet të kryhet modelimi i cilësisë së ajrit në Ballkanin Perëndimor. Duhet të zhvillohen dhe të bëhen të aksesueshme nga publiku materiale informative dhe zgjidhje TI të dedikuara.

Ballkani Perëndimor duhet të përqendrohet tek adresimi më i mirë i ndotjes nga zhurma, veçanërisht duke miratuar dhe zbatuar legjislacioneve përkatës të BE-së për

zhurmën. Planet e veprimeve ndaj zhurmave sipas Direktivës duhet të integrohen në Planet e Qëndrueshme të Lëvizshmërisë Urbane.

Sipas AGJE-së dhe AGJBP-së, në Ballkanin Perëndimor duhet të kryhet vlerësimi i impaktit në cilësinë e tokës nga sektorë të ndryshëm (transporti, industria, bujqësia, etj). Vlerësimi i impaktit duhet të përmbajë masa për integrim më të mirë të ruajtjes dhe mbrojtjes së tokës në këta sektorë. Ndjehet nevoja e identifikimit dhe përcaktimit të zonave me rrezikshmëri erozioni, reduktimi të lëndës organike, kripëzimi, acidifikimi, kontaminimi nga kimikatet, ngjeshjet dhe rrëshqitjet e dheut. Për këtë arsye, në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të miratohet legjislacioneve, dhe të hartohen e të miratohen programe dhe strategji mbi atë se si të luftohen këto probleme. Këtu përfshihen strategjitë për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë/statusit të tokës, për të luftuar vulosjen e tokës dhe për të rimëkëmbur zonat e kontaminuara. Sipas kësaj qasjeje të re të BE-së, duhen mbledhur të dhëna për statusin e tokës. Si pasojë e aksidenteve të përsëritura, toka i nënshtrohet presioneve të konsiderueshme. E për rrjedhojë, nevojitet që në Ballkanin Perëndimor të vlerësohen rreziqet dhe pasojat e aksidenteve, me qëllimin përfundimtar atë të miratimit të rekomandimeve/legjislacioneve për përdorimin e instrumenteve të duhur për rimëkëmbjen e tokës. Rekomandohet fort promovimi i përdorimit të teknologjive dhe novacioneve të gjelbra në menaxhimin dhe përmirësimin e tokës në Ballkanin Perëndimor.

Parandalimi dhe zgjidhja e kontaminimit të tokës lidhet ngushtësisht me politikat për veprimtaritë industriale dhe përdorimin e substancave kimike të cilat tashmë kanë përfunduar procesin e transpozimit në Ballkanin Perëndimor, si për shembull: DEI, Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve (RVAK)¹⁴, produktet

14 Rregullorja (KE) Nr 1907/2006 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit në lidhje me Regjistrimin, Vlerësimin, Autorizimin dhe Kufizimin e Kimikateve (RVAK), e cila ngre Agjencinë Europiane të Kimikateve, duke amenduar Direktivën 1999/45/KE dhe duke shfuqizuar Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr 793/93 dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr 1488/94 si dhe Direktivën e Këshillit 76/769/EEC dhe Direktivat e Komisionit 91/155/EEC, 93/67/EEC, 93/105/EC dhe 2000/21/EC

për mbrojtjen e bimëve (PMB)¹⁵, Rregulloret për fertilizuesit¹⁶ dhe biocidet¹⁷, dhe politikat e mbrojtjes mjedisore për ujin dhe ajrin (p.sh. DPM)¹⁸, Rregullorja për NOQ-ve¹⁹, Rregullorja për PMB-të²⁰ dhe Rregullorja për Mërkurin²¹. Për t'u dhënë zgjidhje përdorimit dhe shkarkimit të kimikateve në mjedis, duhet të krijohen Inventaret e Zonave të Kontaminuara ndërkohë që në Ballkanin Perëndimor duhet të nisë veprimtaria rekuperuese. Për më tepër, duhet të promovohen përpjekjet e përbashkëta për krijimin e një tregu të brendshëm efikas dhe mirëfunksionues për kimikatet, reduktimin e rrezikut tek njeriu dhe mjedisi, rrezik ky që vjen nga disa kimikate të rrezikshme, si karcinogjenet dhe metalet e rënda, dhe duhet të promovohen gjithashtu dispozitat e një kuadri legjislativ parashikues për kompanitë. Politikat duhet të zhvillohen shpejt për t'iu përshtatur AGJE-së dhe novacionit për tranzicionin e gjelbër të industrisë së kimikateve dhe për prodhimin dhe përdorimin e kimikateve të sigurta dhe të qëndrueshme. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet masave që duhet të ndërmerren për të eliminuar kimikatet më të dëmshme si shkatërruesit e endokrinës dhe substancat e qëndrueshme, veçanërisht në produktet konsumatore, si dhe për të minimizuar apo zëvendësuar të gjitha substancat në ekonomi dhe shoqëri.

Në përputhje me AGJE-në, në Ballkanin Perëndimor duhet të ndërmerren veprimtari për reduktimin e ndotjes nga substanca prioritare dhe për të eliminuar emetimin e substancave të rrezikshme përparësore në ujrë sipërfaqësorë për të parandaluar dhe kufizuar kështu depërtimin e ndotësve në ujrë nëntokësorë. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë në procesin e miratimit dhe zbatimit të legjislatimit të BE-së që lidhet

me ujin (d.m.th Direktiva e Kuadrit të Ujit²², Direktiva e Trajtimit të Ujrave në Ndotura Urbane, Direktiva e Ujit të Pijshëm, etj.) të cilat përmbajnë dispozitat për monitorimin dhe raportimin, planifikimin, bashkërendimin mes sektorëve kryesorë, kapacitetin për vlerësimin e riskut, etj., por edhe masat e rëndësishme të zbatimit të cilat nevojiten për të ecur para drejt përmbushjes së objektivit të statusit të ujrave të mira për të gjitha ekosistemet ujore.

Në këtë kuptim, duhet përshpejtuar zhvillimi i Planeve të Menaxhimit të Baseneve të Lumenjve, ndërsa për rajonin është me rëndësi thelbësore identifikimi i burimeve kryesore të ndotjes dhe nisja e punës për reduktimin e plastikës dhe ndotësve të tjerë, zhurmës nënujore dhe kontaminuesve. Duhet gjithashtu të nxiten përpjekjet e përbashkëta dhe të forcohet bashkëpunimi rajonal për të zgjidhur problemin e ndotjes detare dhe për të rregulluar shkarkimin e anijeve në det.

Fusha të tjera ku nevojitet përmirësim janë përdorimi i energjisë, menaxhimi i ujrave të ndotura nga kanalizimet e ujrave të zeza, përmbytjet nga ujat e shirave dhe shkarkimet urbane, menaxhimi i cilësisë së ujrave të larjes, parametrat e përditësuar të cilësisë së ujit të pijshëm, përmirësimi i aksesit në systemin e ujit, etj. Në përputhje me AGJE-së, në Ballkanin Perëndimor duhet të zhvillohen strategji të rëndësishme mbarë ekonomike, të cilat duhet të përkufizojnë veprimet që duhet të ndërmerren për të arritur nivelet e BE për cilësinë e ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Për të mbrojtur burimet e veta ujore, rajoni i Ballkanit Perëndimor duhet të përmirësojë planifikimin duke prezatuar

15 Rregullorja EC 1107/2009 – vendosja në treg e PMB-ve, Miratimi i EC 1107/2009; Direktiva 91/414/EEC – vlerësimi, autorizimi, miratimi i substancave aktive në nivel BE-je dhe autorizimet kombëtare për PMB-të

16 Rregullorja e Parlamentit dhe Këshillit Europian e cila parashtron rregullat për vendosjen në dispozicion në treg të produkteve fertilizuese të BE-së dhe duke amenduar rregulloret (EC) nr. 1069/2009 dhe (EC) nr 1107/2009 dhe duke shfuqizuar rregulloren (EC) nr 2003/2003

17 Rregullorja e BE-së Nr 528/2012 në lidhje me vendosjen në dispozicion në treg dhe përdorimin e produkteve biocidale

18 Direktiva e Përgjegjësisë Mjedisore 2004/35/EC (DPM)

19 Rregullorja e Komisionit (EU) Nr 757/2010 e datës 24 gusht 2010

20 Direktiva e Këshillit e datës 15 korrik 1991 në lidhje me hedhjen në treg të produkteve për mbrojtjen e bimës (91/414/EEC)

21 Rregullorja (EC) Nr 2017/852 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit për mërkurin

22 Direktiva e Ujrave Nëntokësore (2006/118/EC); Direktiva e Standardeve të Cilësisë Mjedisore/Substancave Prioritare (2008/105/EC) siç amendohet nga Direktiva 2013/39/EU; Direktiva për Përmbytjet (2007/60/EC); Rregullorja e Përdorimit të Ujit (EU) 2020/741; Direktiva e Kuadrit të Strategjisë Detare (2008/56/EC); Direktiva e Trajtimit të Ujrave të Ndotura Urbane (91/271/EEC); Direktiva e Ujrave të Larjes (2006/7/EC); Direktiva (EU) 2020/2184 për cilësinë e ujrave për konsumim nga njerëzit

konceptin e riciklimit dhe ripërdorimit të sigurtë të ujit, dhe përmes veprimeve të ndryshme të lehtësoje ripërdorimin e ujit dhe të zgjidhë problemin e mungesës së ujit dhe thatësisë, ndërsa duhet të garantojë shëndetin publik dhe mjedisin në përputhje me Rregulloren e BE-së për kërkesat minimale për ripërdorimin e ujit.

Plani i Veprimtarive për Bujqësi të Qëndrueshme

Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Sektori bujqësor dhe i zhvillimit rural luan një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe atë njerëzor. Nevoja e vazhdueshme për të ushqyer popullatën në rritje e vendos nën trysni disponueshmërinë e burimeve natyrore dhe ndikon mjaft rëndë në mjedis. Kthimi i bujqësisë dhe ekonomisë rurale në të gjelbër është mjaft i rëndësishëm për ruajtjen e përmirësuar të burimeve natyrore, për një efikasitet në rritje të përdorimit të burimeve, për të reduktuar ndikimin negativ të bujqësisë dhe blegtorisë në mjedis, për të forcuar ripërtëritjen klimatike të komuniteteve, dhe për të kontribuar në zbutjen e ndryshimeve klimatike. Si rezultat, transformimi i gjelbër nxit produktivitetin e punës dhe burimeve, i jep hov çrrënjësjes së varfërisë, rrit mundësitë e gjenerimit të të ardhurave dhe përmirëson mirëqenien e njerëzve në zonat rurale.

Nevojiten të zhvillohen politika të duhura bujqësore dhe më pas të zbatohen për të garantuar si qëndrueshmërinë ekonomike ashtu edhe atë mjedisore. Harmonizimi ligjor në fushat e bujqësisë dhe të zhvillimit rural duhet t'i përmbahet Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB) 2023-2027 në vijim të masave të Agjendës së Gjelbër. Shumica e ekonomive të Ballkanit Perëndimor tashmë i zbatojnë disa nga instrumentet PPB, e megjithatë duhet të ndërmerren masa të mëtejshme për të reformuar plotësisht dhe për të modernizuar politikat ekzistuese. Këtu përfshihet gjithashtu edhe nevoja për të përcaktuar një bazë të fortë të dhënash dhe faktesh, në veçanti për çështje që ilustrjnë marrëdhëniet midis bujqësisë dhe mjedisit: përdorimi i pesticideve dhe fertilizuesve,

nivelin e emetimeve të gazrave serrë që gjenerohen nga bujqësia, etj. Të tilla baza të dhënash do të përbënin hapin e parë të nevojshëm për të propozuar vendime politikash bazuar në fakte. Për më tepër, ngritja e kapaciteteve dhe e njohurive të duhura në të gjitha autoritetet e rëndësishme nevojitet për të trajtuar prioritetet brenda kuadrit të Instrumentit për Asistencë Para-aderimit për Zhvillimin Rural (IAPZHR) dhe për të hartuar masat në këtë kuadër të cilat përputhen me politikat e BE-së për bujqësinë dhe zhvillimin rural dhe për t'iu përgjigjur çështjeve që trajtohen nga ky Plan Veprimi.

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të ngrenë sisteme efikase të kontrollit ushqimor në zinxhirët selektiv të vlerave si një mekanizëm mbrojtjeje për sigurinë dhe shëndetin e konsumatorëve. Është një interesin më të mirë të Ballkanit Perëndimor të përqëndrohet në promovimin e sistemeve ushqimore rajonale apo mbarë ekonomike bazuar në standardet dhe parimet e qëndrueshëm akademikë duke trajtuar tërë zinxhirin ushqimor, në përmirësim të gjurmimit dhe etiketimit të produktit. Ngritja e një autoriteti rajonal pune mes vendimmarrësve dhe botës akademike do të sillte zhvillimin e udhëzimeve për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe të rajonit të tërësi. Këto udhëzime do të synojnë të këshillojnë autoritetet e rëndësishme në rajon për strategjitë që do të forconin sistemet e kontrollit ushqimor, do të mbronin shëndetin publik, do të parandalonin mashtrimin, do të shmangnin kontaminimin e ushqimit, do të lehtësonin tregëtinë mes zinxhirëve të caktuar të vlerave dhe do të ndërtonin besueshmërinë e konsumatorëve ndaj sistemit ushqimor. Rekomandimet e bazuara në fakte do t'iu mundësonin autoriteteve (ri)formësimin dhe zbatimin e sistemeve të tyre të kontrollit ushqimor në lidhje me legjislacionin, infrastrukturën dhe mekanizmat specifikë ekonomikë të zbatueshmërisë.

Është gjithashtu me shumë rëndësi përputhja me Standardet e BE-së për Sigurinë dhe Cilësinë e Ushqimeve për produktet shtazore dhe bimore. Konkureshmëria e bizneseve agro-ushqimore të Ballkanit Perëndimor rrezikohet edhe më shumë si rezultat i mungesës së kërkesave dhe standardeve të duhura, informacionit të paplotë

në lidhje me marketingun/brandimin, i paketimit dhe etiketimit të papërshtatshëm, i mungesës së gjurmimit të produktit dhe i mungesës së besimit kundrejt përfitimit që mund të sjellë bashkëpunimi i formalizuar të bizneseve. Ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të zhvillojnë programet dhe udhëzimet e tyre për zbatimin e standardeve të sigurisë dhe cilësisë së ushqimeve në përputhje me kërkesat e BE-së. Për të përmirësuar konkurrencën e sektorit, ekonomitë e Ballkanit Perëndimor duhet të harmonizojnë legjislacionet e tyre. Një Grup Pune Këshillimor Rajonal Ekspertësh për Standardet e Verës dhe Ushqimeve, i cili u ngrit në vitin 2018, duhet ta vazhdojë punën e nisur për politikën e bazuar në fakte dhe të përqendrohet në harmonizimin/përafrimin rregullator të legjislacioneve me rëndësi mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe me rregulloret dhe sistemet e cilësisë të BE-së, përfshirë harmonizimin rajonal të përcaktimit të origjinës, marrëveshjet tregtare rajonale mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, brandimin rajonal të verës, produkteve shtazore dhe bimore, etj. Për më tepër, procesi duhet të përshtatet me kuadrin dhe parimet udhëzuese të Strategjisë nga Ferma tek Piruni për garantimin e prodhimit të qëndrueshëm të ushqimeve.

Bujqësia organike luan një rol kryesor në zhvillimin e sektorit në të ardhmen. Bujqësia dhe blegtoria organike synojnë të zhvillojnë, ose të paktën të ruajnë, rezervat e elementeve ushqyese të tokës përmes pasurimit të lëndës organike të tokës e duke maksimizuar riciklimin e elementeve ushqyese dhe duke reduktuar inputet bujqësore të jashtme. Si e tillë, merr rëndësi kaq të madhe ndërlidhja mes praktikave dhe metodave të përmirësuar të bujqësisë dhe blegtorisë organike me menaxhimin e duhur dhe mbrojtjen e tokës. Për këtë duhen praktika reformuese madhore në sektorin agro-ushqimor dhe masa politikash të cilat do të garantojnë përputhshmërinë mes bujqësisë dhe blegtorisë organike dhe menaxhimit të tokës.

Për të mbështetur këtë proces, duhet të ngrihet Grupi i Punës Këshillimor dhe Rajonal i Ekspertëve (GPKRE) për AGJBP-në me pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe aktorëve të rëndësishëm nga ministrinë dhe institucionet përkatëse (p.sh. agjencitë IAPZHR) me dy nëngrupet nën ombrellën e politikave agro-mjedisore: mbrojtja e tokës dhe bujqësia

organike. Grupet do të përqendrohen në vlerësimin e bazuar në fakte të politikës së zhvillimit rural, dhe në veçanti në mbrojtjen e tokës dhe bujqësisë organike. Në mënyrë më specifike:

- GPKRE Toka – Objektivi: Vendosija e partneritetit rajonal të tokës për të përmirësuar shkëmbimin e njohurive dhe për të identifikuar praktikën më të mirë për mbrojtjen e tokës nga ndotja dhe degradimi. Kjo punë duhet të ndërmarrë një qasje të integruar për të garantuar vazhdimësinë edhe në impaktin e ndotjes në ujë dhe ajër.
- GPKRE Organik – Objektivi: promovimi i bujqësisë dhe blegtorisë organike dhe miqësore me mjedisin dhe reduktimi i produkteve sintetike kimike që përdoren në prodhimin e ushqimeve. Dhënia e mbështetjes ndaj procesit të prezantimit të kontrollit dhe gjurmueshmërisë së bujqësisë dhe blegtorisë dhe produkteve organike.

Bashkëpunimi me ente shkencore, arsimore, tregtare dhe bujqësore për të lehtësuar tranzitin e teknologjive dhe të metodave të bujqësisë dhe blegtorisë novatore dhe miqësore me mjedisin do të zbatohet përmes strukturave të transferimit të njohurive dhe novacionit në Ballkanin Perëndimor si bazë kjo e Sistemit rajonal të Novacionit dhe Njohurive Bujqësore (SNNJB). Kjo do të pasohet nga ngritja dhe zhvillimi gradual i një rrjeti rajonal të novacionit (GPKRE SNNJB) për të lehtësuar transferimin e teknologjive dhe të metodave të bujqësisë dhe blegtorisë novatore dhe miqësore me mjedisin. Anëtarët e rrjetit duhet të jenë përfaqësues të ministrive dhe shkencëtarë në fushën e politikave të novacionit, si dhe ekspertë nga organizata kryesore rajonale dhe europiane të novacionit për teknologjitë si në bujqësi ashtu edhe në ushqim.

Rrjeti do të përqendrohet në zhvillimin e planeve strategjike rajonale dhe të ekonomive të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e SNNJB-ve, p.sh. për teknologjitë novatore dhe miqësore ndaj mjedisit, për sigurinë e ushqimit dhe cilësinë dhe digjitalizmin. Për më tepër, rrjeti do të mbështesë procesin e përmirësimit të programeve të formimit formal

dhe joformal për të trajtuar nevojën për kërkim, novacion dhe digjitalizim në bujqësi, për të përfshirë klasa mësimore praktike në fushën e teknologjive bujqësore dhe ushqimore dhe për t'i përafuar ato me nevojat e tregjeve në të ardhmen.

Rrjeti Kombëtar Rural do të shërbejë si një zgjatim i Ministrive të Bujqësisë, veçanësisht në kuadrin e IAPZHR-së dhe instrumenteve të veta zbatuese. Për të mbështetur këtë proces, Rrjetet Kombëtare të Zhvillimit Rural (RRKZHR) dhe anëtarët e tyre duhet të përmirësojnë kapacitetet e tyre për promovimin e zhvillimit rural dhe për udhëzimin e përmirësuar të shërbimeve të RRKZHR-vë respektive. Ndër to përmendim mbështetjen në formën e shkëmbimit të njohurive dhe praktikave më të mira me aktorët ruralë për çështje të ndryshme, në veçanti për modernizimin e fermave dhe të përpunimit, për diversifikimin e aktiviteteve rurale dhe mundësive të sipërmarrjes, për mirëmbajtjen dhe vlefshmërinë e trashëgimisë natyrore, kulturore dhe tradicionale të zonave rurale.

Për të drejtuar procesin, duhen të konsolidohen Strategjitë LEADER të Zhvillimit Lokal të Grupeve Lokale të Veprimit nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor të cilat mbështesin diversifikimin ekonomik gjithëpërfshirës dhe miqësor me mjedisin dhe klimën.

Praktikat apo kuadri strategjik i menaxhimit të mbetjeve janë pothuajse inekzistente në zonat rurale të Ballkanit Perëndimor. Për shkak të sistemit të dobët të menaxhimit të mbetjeve rurale, duket e vështirë të arrihet zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtja e duhur mjedisore. Nevojiten strategji tërësore dhe zhvillim i përmirësuar i politikave me një komponent të fortë të parandalimit dhe riciklimit të mbetjeve i zbatuar përmes bashkëpunimit dhe bashkërendimit të aktorëve ndërsektorialë për menaxhimin e mbetjeve. Këtu përfshihet monitorimi i mbetjeve dhe burimeve të tyre, planifikimi për reduktimin e mbetjeve, rritja e kapacitetit teknik dhe organizativ të bashkive/ndërmarrjeve që merren me menaxhimin e mbetjeve, rritja e ndërgjegjësimit të

shoqërisë për menaxhimin e duhur të mbetjeve dhe pasojat negative të keqmenaxhimit të mbetjeve, zbatimi i programit të parandalimit të mbetjeve pluskuese dhe lehtësimi i veprimeve pastruese me të rinjtë dhe vullnetarë.

Nevojitet zhvillimi i një dokumenti politikash bazuar tek faktet dhe i raportit të vlerësimit për të ngritur bazat e të dhënave për emetimet aktuale nga bujqësia në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor. Planifikohet gjithashtu edhe ngritja e Grupi të Punës Këshillimor dhe Rajonal të Ekspertëve në nivel teknik që do të jetë përgjegjës për zhvillimin e raporteve përmbledhëse të ekonomive të Ballkanit Perëndimor për mangësitë, sfidat dhe nevojat dhe se si të realizohet përshtatja me ndryshimet klimatike në veçanti në sektorin bujqësor.

Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rajonal Rural (GPP ZHRR) do të lehtësojë gjithashtu rritjen në prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe në investimet tek teknologjitë e rëndësishme përmes promovimit të masave të duhura IAPZHR dhe progameve mbështetëse të ngjashme me IAPZHR në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor ku dhe mundësohen të tilla instrumente. Do të merren parasysh edhe sinergjitë me/ rrezik impakti negativ në cilësinë e ajrit.

Procesi do të zbatohet përmes GPKRE-së për IAPZHR-në që do të përqëndrohet në përmirësimin e masave IAPZHR mbarë ekonomike dhe të sistemeve administrative mes Agjencive Paguese dhe Autoriteteve Menaxhuese për zbatimin efikas të mbështetjes teknike. GPKRE-ja do të synojë të mundësojë transferimin e njohurive për standardet relevante të BE-së, rrjetëzimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit për asistencën teknike dhe masat trajnuese, si dhe për ngritjen e kapaciteteve të administratës dhe përfituesve përfundimtar për të përmirësuar përthithjen e fondeve dhe përputhjen me masat e BE-së.

Plani i Veprtarive për Mbrojtjen e Natyrës dhe Biodiversitetit

Pjesa e parë: Sfidat ekzistuese në Ballkanin Perëndimor

Rajoni i Ballkanit Perëndimor është tejet i pasur në shumëllojshmërinë e specieve dhe habitateve. Shumë nga speciet që gjenden në rajon janë endemike. Pavarësisht kësaj, mbrojtja e biodiversitetit dhe e burimeve natyrore nuk bëhet siç duhet. Humbja e biodiversitetit dhe e habitateve vihet re në tërë rajonin ku disa specie kërcënohen nga zhdukja. Edhe pse biodiversiteti dhe ekosistemet luajnë një rol kryesor në sigurimin e ujit të pastër, ajrit dhe ushqimit që konsumojmë, dhe në garantimin e përshtatjes klimatike dhe reduktimin e rrezikut të katastrofave, në zhvillimin e politikave më të gjera rrallë merren në konsideratë aspektet e biodiversitetit dhe shërbimet e ekosistemit. Në të njëjtën kohë, masat institucionale në sektorin e biodiversitetit janë të pamjaftueshme dhe shpesh janë me kapacitet të pamjaftueshëm me mbështetje të pakët nga politikat sektoriale dhe zbatueshmërinë e ligjit.

Në këtë fushë, prioritetet kryesore për rajonin e Ballkanit Perëndimor janë frenimi i humbjes së biodiversitetit, integrimi i objektivave të Strategjisë së BE-së për Biodiversitetin për 30% të zonave të mbrojtura dhe 10% të zonave rreptësisht të mbrojtura, trajtimi i çështjes së ruajtjes të shërbimeve të biodiversitetit dhe ekosistemeve dhe rimëkëmbja e ekosistemeve, transpozimi dhe garantimi i zbatimit të Direktivës për Zogjtë dhe Habitatet, integrimi i të gjithë këtyre elementeve në Planin Strategjik për Biodiversitetin e Ballkanit Perëndimor 2030, dakordësimin me një pozicion të përbashkët rajonal në lidhje me Konferencën 15të të Palëve (COP 15) për Konventën e Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik (KDB) dhe për të punuar drejt përmirësimit të objektivave të biodiversitetit të BE-së dhe atyre globale post 2020.

Pasuria e Ballkanit Perëndimor në biodiversitet dhe ekosisteme natyrore ofron përfitime të vlefshme për komunitetet lokale. Në të njëjtën kohë, rajoni përballë me sfida në lidhje me presionin dhe impaktin që kanë në natyrë zhvillimi urban, ndërtimi i rrugëve, digave, gjuetia e paligjshme dhe praktikave të paqëndrueshme të pylltarisë. Trendi i zhvillimit të shpejtë

(veçanërisht korridoret e transportit) krijon presion të shtuar në zonat natyrore dhe përbën një rrezik të lartë të fragmentimit të habitatit.

Mbrojtja dhe menaxhimi i bashkërenduar dhe i qëndrueshëm i hapësirave ndërkufitare të zonave të mbrojtura dhe korridoreve të gjelbër janë mjaft të rëndësishme për qëndrueshmërinë afatgjatë të ndërlidhshmërisë ekologjike në rajon. Kjo do të thotë përmirësim të bashkëpunimit rajonal në fushat e ndërlidhshmërisë ekologjike dhe menaxhim të bashkërenduar të hapësirave/zonave natyrore ndërkufitare të zonave të mbrojtura.

Mbulimi i peizazheve me potencial për të dhënë shërbime ekosistemi në rajonin e Ballkanit Perëndimor mbetet i lartë, veçanërisht pyjet në zonat malore, ekosistemet natyrore rreth liqeneve të mëdhenj dhe sistemet e gjera natyrore lumore. Duhet t'i jepet përparësi zhvillimit të infrastrukturës dhe ndërlidhshmërisë së gjelbër mes ekosistemeve dhe habitateve. Ekzistojnë mundësi të mëdha për t'i lidhur korridoret e gjelbra me rajonin e gjerë, gjë që e rrit më tej ndërlidhshmërinë ekologjike dhe kontribuon së tepërmi në rrjetin Trans European të natyrës.

Për këtë do të nevojitet bashkëpunimi në nivel rajonal, informacion dhe njohuri më të thelluara shkencore, zbatim i duhur i legjisllacionit për mbrojtjen e natyrës, forcimi i kapaciteteve institucionale në të gjitha nivelet administrative përgjegjëse për ruajtjen e natyrës, rritje e ndërgjegjësimit në lidhje me përfitimet sociale dhe ekonomike të ekosistemeve të lidhur funksionalisht, angazhimi i aktorëve dhe publikut të gjerë në planifikimin dhe menaxhimin e rrjeteve ekologjike dhe në garantimin e burimeve financiare.

Politikat dhe strategjitë sektoriale duhet të përditësohen për të integruar politikën e BE-së për Infrastrukturën e Gjelbër dhe për të ndërthurur objektivat dhe praktikave që lidhen me mbrojtjen e elementeve të Infrastrukturës së Gjelbër.

Zbatimi i legjisllacionit ekzistues për ruajtjen e natyrës duhet të vijojë duke përmirësuar kontrollin e praktikave të jashtëligjshme në nivel terreni me impakt të drejtpërdrejtë në cilësinë e ndërlidhshmërisë së habitateve natyrore me popullatat e specieve të rrezikuara (gjuetia e jashtëligjshme, prerja pa kriter e drurëve), dhe duke përmirësuar

përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe procedurat për leje që lidhen me impaktin e projekteve të infrastrukturës në biodiversitet dhe ekosisteme (impiante energjitike, infrastrukturat rrugore, nxjerrja e lëndës së parë). Hartëzimi i detajuar i habitatit, mbledhja dhe analizimi i të dhënave nga studimet dhe monitorimi në terren i popullatave të specieve ombrellë duhet të kryhet si pjesë e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e natyrës dhe ngritjen e Natura 2000

Meqenëse ekonomitë e Ballkanit Perëndimor janë relativisht të vogla dhe shpesh zonat kryesore të biodiversiteti kanë rëndësi ndërkuftare, nevojitet një qasje e bashkërenduar rajonale dhe ndërkuftare. Bashkërendimi rajonal mes autoriteteve kryesore në hartimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura përbën një faktor kyç për sinergji më të mira dhe menaxhim efikas të rrjeteve të zonave të mbrojtura dhe atyre ekologjike. Për të siguruar zbatimin efikas në terren, mund të ngrihet një mekanizëm rajonal për bashkërendimin e veprimeve të përbashkëta me qëllim zhvillimin e ndërlidhshmërisë së Infrastrukturës së Gjellbër dhe ekosistemit.

Pjesa e dytë: Hapat e mëtejshme

Shtylla e biodiversitetit në Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor do të zbatohet në tre faza kryesore:

Faza e parë (2021-2022) synon zhvillimin e studimeve të të dhënave dhe të vlerësimeve në mbështetje të veprimtarive 51 deri 54 dhe për të krijuar mundësi për nxitjen e përafrimit të acquis-ve të BE-së për natyrën dhe të bashkëpunimit mes Ballkanit Perëndimor dhe BE-së në zbatimin e AGJBP-së dhe të kuadrit global për biodiversitetin post 2020 që lidhen me veprimtaritë 55 dhe 56.

Mes rezultateve kryesore janë:

- Raporti i Ballkanit Perëndimor për Biodiversitetin do të krijojë bazën e të dhënave për të matur ecurinë e Planit Strategjik 2030 të Ballkanit Perëndimor për

Biodiversitetin dhe për të ofruar informacion për planet dhe vlerësimet rajonale të ekonomive të Ballkanit Perëndimor si raportet e BE-së për vendet në fjalë, BSAB-et, raportet PNSHBS dhe KDB, etj.;

- Raporti i Vlerësimit të Mundësive për Përmirësimin e Tokës për Ballkanin Perëndimor do të identifikojë përmasat e degradimit të peizazhit pyjor dhe zonave dhe habitateve prioritare për përditësimin e ekosistemit në rajon si bazë për një Plan rajonal për Përmirësimin e Peizazhit Natyror (PPN);
- Raporti për Ndryshimin Klimatik dhe Lidhjen e Biodiversitetit dhe rekomandimi për pikat e hyrjes për integrimin e tyre në politikën, strategjitë dhe planet e ndryshimeve klimatike, përfshirë komponentin e AGJBP-së për dekarbonizimin, KPK-të dhe PKP-të. Raporti do të përfshijë indikatorë specifikë për specie për të gjurmuar kështu pasojat e ndryshimeve klimatike në speciet dhe habitatet;
- Kuadri i monitorimit dhe vlerësimit të biodiversitetit do të përdoret si bazë për zhvillimin e Pikës së Informacionit të Ballkanit Perëndimor për Biodiversitetin. Indikatorët do të përafrohen me ato të Agjencisë Europiane të Mjedisit (AEM), objektivat e përcaktuara nga Strategjia e BE-së për Biodiversitetin për 2030 dhe Kuadri KDB Global për Biodiversitetin post 2020.

Faza e dytë (2022-2024) e komponentit do të përqëndrohet në zhvillimin e dokumenteve dhe planeve strategjike rajonale, dhe të mekanizmave për monitorimin dhe raportimin, përfshirë (i) Planin Strategjik të Ballkanit Perëndimor për Biodiversitetin 2030; (ii) Planin i Ballkanit Perëndimor për Përmirësimin e Peizazhit Pyjor; (iii) plane lokale për mbrojtjen dhe përmirësimin e natyrës përfshirë zonat detare; (iv) zhvillimin e një plani veprimtarish për krijimin e Pikës së Informacionit të Ballkanit Perëndimor për Biodiversitetin.

Faza 2 do të promovojë përafrimin e politikave rajonale dhe mbarë ekonomike me Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin, Agjendën e Gjellbër të BE-së dhe Kuadrin KDB Global për Biodiversitetin post 2020. Task Forca për Biodiversitetin (TFBD) për Europën

Juglindore (EJL) do të lehtësojë bashkërendimin rajonal të angazhimeve mbarë ekonomike dhe do të propozojë iniciativa ndërkufitare mes ekonomive të Ballkanit Perëndimor dhe VA të BE-së.

Puna në këtë fazë do të synojë integrimin e politikës së BE-së për natyrën dhe Kuadrin KDB Global për Biodiversitetin post 2020 me strategjitë rajonale dhe legjislacionin e ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Dokumentat e politikave do të shoqërohen me veprimtari në përputhje me zbatimin e acquis-ve të BE-së që lidhen me biodiversitetin për Mbrojtjen e Natyrës (Direktiva për Zogjtë (2009/147/EC) dhe Direktiva për Habitatet (92/43/EEC), me Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin për 2030, Strategjinë e BE-së për Pyjet për 2030, duke përfshirë Legjislacionin Horizontal – veçanërisht ato të Direktivës INSPIRE (2007/2/EC) dhe do të mundësojnë kontributin në të tjerë iniciativa kyçe tematike si Sfida Bonn dhe ECCA30. Dokumentacion tjetër referimi do të përfshijë objektivat detyruese të BE-së për përmirësimin e ekosistemit, Udhëzimet për pyllëzimin dhe shpyllëzimin në BE dhe Sfidën Bonn.

Faza 2 do të përfundojë në vitin 2024 me një raport afatmesëm për ecurinë rajonale dhe në nivel ekonomik të Ballkanit Perëndimor dhe për nivelin e ambicieve dhe angazhimeve nga ana e aktorëve qeveritarë dhe jo-qeveritarë në rajon për ruajtjen e natyrës. Raporti pritet të prezantohet në LP 16 KDB.

Ndër rezultatet kryesore mund të përmendim:

- Plani Strategjik i Ballkanit Perëndimor për Biodiversitetin i cili përmban objektiva dhe indikatorë të harmonizuar më Strategjinë e BE-së për Biodiversitetin 2030, Agjendën e Gjelbër të BE-së dhe Kuadrin KDB Global për Biodiversitetin post 2020 përfshirë indikatorët e përdorur për raportimin KDB;
- Plani i Ballkanit Perëndimor për Përmirësimin e Peizazhit, përfshirë një plan financiar, për të promovuar strategjitë e përbashkëta për mobilizimin e burimeve për PPP-të dhe për të identifikuar mundësitë për nxitjen e menaxhimit dhe përmirësimin të

qëndrueshëm të pyjeve. Plani i Ballkanit Perëndimor për Përmirësimin e Peizazhit do të ndihmojë në identifikimin e fushave kryesore për tipe përmirësimi dhe ndërhyrjeje dhe në kontributin e fondeve vendase dhe ndërkombëtare për përmirësimin e ekosistemit;

- Pika e Informacionit të Ballkanit Perëndimor për Biodiversitetin do të plotësojë sistemet kryesore informative për biodiversitetin (p.sh Sistemin e Informacionit për Biodiversitetin për Europën (SIBE), dhe do të japë udhëzime të detajuara për mbledhjen e standardizuar të të dhënave për secilën nga speciet e grupimeve taksonomike (shpende, gjitarë, amfibë, reptilë dhe bimë vaskulare – Direktiva e BE-së për Habitatet, Shtojca 2 dhe Shtojca 4), në vijim të standardeve të të dhënave për biodiversitetin – skema Darwin Core dhe ABCD dhe udhëzimet rajonale të Ballkanit Perëndimor.

Faza 3 (2024-2030) do të përqëndrohet në mbështetjen e mobilizimit të burimeve financiare dhe njerëzore për të promovuar zbatimin efikas të angazhimeve të AGJBP-së dhe për të garantuar monitorimin dhe raportimin për angazhimet rajonale dhe ato mbarë ekonomike. Indikatorët e kuadrit global të biodiversitetit post 2020 dhe indikatorët e Agjendës të Gjelbër do të monitorohen dhe raportohen rregullisht pranë GRP-së për Mjedisin. Vlerësimet vjetore të zbatimit të planit të punës përfshirë veprimet e propozuara në dokumentet strategjike të zhvilluar gjatë fazës 2 do të hartohen nga TFBD EJL dhe do t'i paraqiten GRP-së për Mjedisin.

Ndër rezultatet kryesore përmendim:

- Raportet vjetore GRP-së për Mjedisin;
- Progres raporti afatmesëm për zbatimin e shtyllës së biodiversitetit të AGJBP-së në vitin 2025;
- Raporti përfundimtar për zbatimin e shtyllës së biodiversitetit të AGJBP-së në vitin 2030.

PJESA 3 – QEVERISJA, MONITORIMI, RAPORTIMI DHE MEKANIZMAT E TJERË PËR TË MBËSHTETUR ZBATIMIN E DEKLARATËS SË SOFJES

QEVERISJA

Për të lehtësuar zbatimin e Deklaratës së Sofjes për AGJBP-në, duhet të ndërmerren veprime të vendosura për të siguruar angazhimin dhe bashkëpunimin rajonal, qasjen e shumë aktorëve, bashkëpunimin ndërsektorial përmes përfshirjes së të gjitha autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, si dhe për të garantuar forcimin e bashkëpunimit në të gjitha nivelet. Për këtë arsye, KBR-ja është angazhuar të ngrejë dhe mirëmbajë platforma të ndryshme përmes të cilave do të ofrohen këto elementë. Për të drejtuar tërë procesin, që në fazën e hershme të tij do të përfshihen politikëbërës dhe përfaqësues të autoriteteve të Ballkanit Perëndimor të cilët janë përgjegjës për fusha të ndryshme politikash të parashikuara në Agjendën e Gjelbër. Grupi Rajonal i Punës për Mjedisin (GRP Mje) i themeluar në vitin 2015 si një platformë ndërqeveritare për dialogun e përhershëm mbi politikat për veprimtaritë mjedisore dhe klimatike, do të përbëjë dhe shtyllën kryesore ku do të mbështetet ky proces. Me mbështetjen e Task Forcës së Europës Juglindore për Biodiversitetin, ngritur në vitin 2017 si një organ këshillimor në fushën e biodiversitetit e me veprimtari të gjerë që parashikon pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ministrive të tjera të linjës, Grupi Rajonal i Punës do të shërbejë si një mekanizëm që do të garantojë angazhimin rajonal si dhe përfshirjen aktive dhe rolin drejtues që autoritetet e Ballkanit Perëndimor do të marrin në procesin e përmbushjes së angazhimeve të Deklaratës së Sofjes. Ngritja e urave të forta të bashkëpunimit ndërsektorial do të jetë një element kyç i një mekanizmi të suksesshëm qeverisjeje, duke patur parasysh natyrën e ndërlikuar dhe multidisiplinare të Programit të Gjelbër, si dhe nevojën e madhe për të gjetur zgjidhje ndaj çështjeve mjedisore dhe klimatike përmes një qasjeje tërësore.

Për të lehtësuar drejtimin dhe për të mundësuar një proces vendimmarrës sa më të mirëinformuar, KBR-ja ka rolin e sigurimit dhe mirëmbajtjes së një platforme për dialogun me shërbimet e Komisionit European, organizatat e rëndësishme rajonale të cilat kanë veprimtari apo mandate në fusha të rëndësishme politikash në rajonin e Ballkanit Perëndimor (si Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKEn), Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit (SPKT), Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rajonal Rural (GPP ZHRR), Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (UNRN), etj.), me institucionet ndërkombëtare financiare, partner të ndryshëm socio-ekonomik, organizata jo-qeveritare, komunitetin akademik dhe shkencor. Diskutimet do të zhvillohen përmes takimeve të periodike dhe të jashtëzakonshme të GRP Mje në nivel operacional, siç parashikohet në Termat e Referencës së Grupit Rajonal të Punës për Mjedisin. Ky dialog do të mundësonte shkëmbimin e informacionit dhe mbështetjen ndaj autoriteteve të Ballkanit Perëndimor bazuar në kërkesat për përafrim, zhvillimet e fundit në politika dhe procese të tjera me rëndësi, pa rrezikuar apo ndërhyrë në planet dhe mandatet e organizatave rajonale.

Përveç dialogut të përhershëm në nivel operacional, takimet ministrore vjetore që organizohen sipas kuadrit të GRP Mje do të rishikojnë procesin e arritur në vitin paraardhës përmes mekanizmave monitorues dhe raportues të ngritur nga KBR-ja dhe partnerët rajonalë, do të miratojnë raportet vjetore për ecurinë e AGJBP-së, dhe bazuar mbi këto elemente dhe prioritetet e identifikuara, përmes deklaratave të përbashkëta, do të hartojnë udhëzimin e zbatimit për vitin e ardhshëm. Po ashtu si GRP Mje, takimet ministrore mund të mbahen në format të zgjeruar për të përfshirë ministrat përgjegjës për të gjitha fushat e politikave që përfshin AGJBP-ja.

Ky model qeverisjeje do të plotësohet nga dy platforma të tjera përmes të cilave politikëbërësit nga Ballkani Perëndimor do të marrin inpute shtesë, që kanë të bëjnë me qëndrime të ndryshme dhe reagime bazuar tek përvojat parë nën këndvështrime të ndryshme rolesh dhe zbatimi. Këto dy platforma janë Forumi i Organizatave Jo-Qeveritare për Zbatimin e Agjendës të Gjelbër për Ballkanin Perëndimor (i ashtuquajtur: Forumi OJQ) që do të mundësojë shkëmbimin e përvojës dhe njohurive, si dhe do të sigurojë lehtësimin e procesit të vendimmarrjes në rast mosdakordësimi pikëpamjesh. Platforma e dytë e cila do të garantojë mekanizmin e bashkërendimit dhe reagimit vertikal bazuar në përvojën e zbatimit dhe sfidave të hasura do të jetë iniciativa e Ditëve të Agjendës të Gjelbër (DPGJ). E organizuar për qeverisjen vendore (QV) si një proces bashkëpunimi, kjo platformë do të kthehet kështu në një organizim të përvitshëm që do të mundësojë shkëmbimin e njohurive dhe promovimin e veprimtarive në sektorin publik në nivel vendor që kontribuojnë në përmbushjen e angazhimeve të Deklaratës së Sofjes dhe që përmirësojnë mirëqenien e qytetarëve në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Financimi do të jetë një element tejet i rëndësishëm për zbatimin me sukses të AGJBP-së. Nevoja ekzistuese urgjente për një kalim të gjelbër të thelluar përmes depërtimit në të gjithë sektorët e ekonomisë do të kërkojë procese jashtëzakonisht të kushtueshme. Me prezantimin e standardeve të larta ekologjike përmes AGJE-së dhe AGJBP-së, dhe duke patur parasysh situatën aktuale në rajonin e Ballkanit Perëndimor për sa i përket përafrimit me politikën e BE-së dhe zbatimin të legjislativës, ky tranzicion sjell me vete kërkesa të larta dhe tension financiar. Ai përbën edhe shumë sfida socio-ekonomike dhe të llojeve të tjera, përfshirë këtu përmbushjen e kërkesave për të garantuar një tranzicion të drejtë dhe një zhvillim të ekuilibruar në aspektin social. Për këtë arsye, autoritetet e Ballkanit Perëndimor kanë nevojë të ngutshme për mbështetjen e komunitetit ndërkombëtar dhe atij të donatorëve për dhënien jo vetëm të mbështetjes teknike por edhe të asaj financiare. Për të bashkërenduar këtë proces, për të

mundësuar identifikimin e mungesave dhe të prioriteteve dhe për të nxitur dialogun e vazhdueshëm për nevojat dhe mundësitë financiare, KBR-ja do të bashkëpunojë ngushtësisht me donatorë potencialë dhe organizatat e interesuara në mbështetje të zbatimit të Deklaratës së Sofjes dhe do të organizojë Takimin vjetor të Bashkërendimit të Donatorëve. Bashkërendimi i mbështetjes financiare dhe veprimtarive që lidhen me të do të jetë faktori për garantimin jo vetëm të suksesit të këtij tranzicioni të vështirë por gjithashtu do të përshpejtojë tërë procesin dhe si rezultat do t'i japë mundësinë ekonomive të Ballkanit Perëndimor të jenë në të njëjtin hap me VA BE të cilat tashmë po ecin para në rrugën e tyre derjt neutralitetit të klimës. Procesi i Bashkërendimit të Donatorëve do të luajë gjithashtu një rol të rëndësishëm në plotësimin e boshllëqeve dhe në rritjen e efikasitetit të kapaciteteve që ekonomitë e Ballkanit Perëndimor kanë për të përthithur nga mbështetja financiare dhe teknike dhe për të bashkërenduar më mirë mekanizmat, fondet dhe ekspertizën e dhënë. Përmes këtij procesi dhe kësaj mbështetjeje financiare, zbatimi i Deklaratës së Sofjes do të ofrojë mundësi të ndryshme (që lidhen me zhvillimin e gjelbër) për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe do të sjellë përfitime të shumta socio-ekonomike.

Mekanizmi i qeverisjes i prezantuar më lart do të garantojë zbatimin efikas të Deklaratës së Sofjes dhe do të sjellë përfitime të tjera për sa i përket forcimit të kapaciteteve administrative për zbatimin e duhur dhe në afat përmes bashkëpunimit rajonal dhe përfshirjes në proces të aktorëve të ndryshëm me ekspertizën e tyre. Nga ana tjetër, dialogu me INF-të dhe komunitetin e donatorëve do të ndihmojë në përmirësimin dhe rritjen e kapaciteteve përthithëse të ekonomive të Ballkanit Perëndimor përmes maksimizimit të sinergjive dhe përsëritjes së iniciativave të suksesshme në mënyrë efçente. Për të siguruar mbështetje të vazhdueshme ndaj procesit, duhet të shihet mundësia dhe të forcohet bashkëpunimi dhe dialogu mes përfaqësuesve në parlament si dhe roli i komisioneve për mjedisin

Autoritetet e Ballkanit Perëndimor

Task Forca e Europës Juglindore për Biodiversitetin

Grupi Rajonal i Punës për Mjedisin

Ministritë e Linjës nga Ballkani Perëndimor

Platforma e Bashkëpunimit
(takime periodike bashkërendimi (min. 2 në vit) me KBR, KE, SKE, SPKT, GPP ZHRR, UNRN, INF-të, partnerë të ndryshëm socio-ekonomik, komuniteti akademik e shkencor...)

Forumi i OJQ-ve

Ditët e Agjendës të Gjelbër për Vetëqeverisjen Vendore

Platforma e Bashkërendimit të Donatorëve

Mekanizmat Mbështetës

Komuniteti i Biznesit

Rinia

Diagrama 1. Mekanizmi i Qeverisjes

PJESËMARRJA E SHOQËRISË CIVILE

Organizatave të shoqërisë civile luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetje të tërë procesit me qëllim përmbushjen e angazhimeve të Deklaratës së Sofjes dhe përmes njohurive të tyre në fushën në fjalë dhe përvojën praktike, ato mund të lehtësojnë tranzicionin e gjelbër ambicioz që pritet të ndërmerret nga rajoni i Ballkanit Perëndimor. Kontributi i tyre në zbatimin e Deklaratës së Sofjes mundësohet përmes Forumit të OJQ-ve për Zbatimin e Agjendës të Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Forumi mundëson dialogun mes organizatave të identifikuara nga Ballkani Perëndimor dhe të disa organizatave më në zë dhe aktive nga VA BE. Dialogu do të zhvillohet në takimet periodike të organizuara nga KBR-ja në bashkëpunim të ngushtë me KE-në. Rezultatet, përfundimet dhe rekomandimet që do të dalin nga këto takime do të komunikohen në takimet e GRP Mje. nga Kryetari i Forumit të OJQ-ve. Në këtë mënyrë, të gjithë autoritetet e rëndësishme vendimmarrëse do të informohen në mënyrë të drejtpërdrejtë në lidhje me inputet dhe rekomandimet nga sektori i OJQ-ve.

Forum i OJQ-ve përbëhet nga organizata të ndryshme të identifikuara me përvojë në fushat që mbulohen nga AGJBP-ja. Përzgjedhja fillestare e organizatave më të rëndësishme dhe ngritja e Forumit të OJQ-ve u bë në fillim të vitit 2021 bazuar në përvojën e KBR-së dhe bashkëpunimit të saj të vijueshëm me organizata aktive në fushën e politikave të parashikuara në Agjendës e Gjelbër. Përzgjedhja do të bazohet në interesin e shprehur nga disa OJQ në kuadër të përgatitjes së Deklaratës së Sofjes dhe gatishmërisë për të kontribuar në zbatimin e saj. Këtu mund të përmendim Propozimin e Përbashkët të OJQ-ve për AGJBP-në përgatitur në prill të vitit 2020 dhe ndarë me KE-në dhe KBR-në, si dhe Deklarata e Përbashkët e organizatave të shoqërisë civile dorëzuar autoriteteve të Ballkanit Perëndimor gjatë përgatitjes së Samitit të Sofjes (nëntor 2020) Lista fillestare është plotësuar nga OJQ-të mjedisore të identifikuara nga Projekti për Programin e Pëartneritetit Mjedisor për Aderimin (PPMA) dhe më tej është pasuruar me OJQ-të e identifikuara përmes studimeve të kryera nga KBR-ja dhe në konsultim m KE, DP FNZ. Lista e OJQ-ve përmban më shumë se 50 organizata dhe

është një dokument dinamik i cili mund të rishikohet për të përfshirë OJQ të tjera (për të mundësuar përfshirjen e organizatave të tjera përfshirë ato që do të krijohen në të ardhmen) nëse shfaqin interes për t'iu bashkuar Forumit duke sjellë me vete ekspertizën dhe përvojën në mbështetje të angazhimeve të AGJBP-së. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet garantimit të pjesëmarrjes së grupeve vulnerabël në veprimtarinë e Forumit të OJQ-ve, si komunitetit rom.

Përveç rolit që luan në mbështetje të proceseve politikë-bërëse, Forumi i ngritur i OJQ-ve ka shumë objektiva të tjera dhe efekte pozitive siç është monitorimi i ecurisë, ku dhe do të bazohet identifikimi dhe zbatimi i inputeve dhe ideve të reja, si dhe veprime korrigjuese të caktuara. Përmes takimeve periodike dhe dialogut të përhershëm mes përfaqësuesve të sektorit të OJQ-ve dhe mundësisë së raportimit të gjetjeve dhe prezantimit të propozimeve tek politikë-bërësit në Ballkanin Perëndimor, ky organizëm jo formal përfaqëson një mekanizëm tjetër që mbështet drejtimin e zbatimit të AGJBP-së. Veprimtaritë e Forumit hartohen për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm të qytetarëve të Ballkanit Perëndimor për klimën, mjedisin dhe fusha të tjera politikash dhe procese që lidhen me AGJ-në, dhe për progresin e arritur, në përpjekje për të rritur më tej kapacitetet e sektorit të OJQ-ve në rajon. Nëpërmjet veprimtarive të përbashkëta në arritjen e objektivave të përbashkët, pavarësisht pikëpamjeve të ndryshme, bashkëpunimi mes sektorit të OJQ-ve dhe organizmave të administratës publike në Ballkanin Perëndimor do të forcohet në të mirë të të dyja palëve bazuar në parimet e partneritetit.

Puna e Forumit të OJQ-ve mbështetet nga KPR-ja që bashkërendon veprimtaritë e tij dhe organizon takime periodike dy herë në vit (preferohet që takimet të mbahen para atyre të GRP-së Mje.). Në rastet kur pjesëmarrësit e Forumit, kanë nevoja urgjente, mund të mbahen edhe takime të jashtëzakonshme. Për të mbështetur KBR-në dhe për të lehtësuar përpjekjet e përgjithshme, Forumi ka një Kryetar/e me një mandat prej gjashtë muajsh. Kryetari angazhohet mbi baza vullnetare dhe identifikohet/zgjidhet nga pjesëmarrësit e Forumit në takimet periodike të tij. Roli i Kryetarit është

të bashkëpunojë ngushtësisht dhe të mbështesë KBR-në në organizimin e takimeve, në hartimin e agjendës, zhvillimin e ideve dhe identifikimin e prioritetëve për diskutim, në drejtimin e sesioneve dhe në hartimin e përfundimeve të takimit. Roli i Kryetarit është gjithashtu të raportojë për përfundimet e nxjerra në takimet periodike dhe të jashtëzakonshme të GRP-së Mje.

Përfundimet e takimeve si dhe gjetjet e studimeve dhe analizave të kryera nën kuadrin e Forumit të OJQ-ve u prezantohen autoriteteve të duhura të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, organizatave rajonale, INF-ve dhe partnerëve të tjerë, përmes pjesëmarrjes së kryetarit të Forumit të OJQ-ve në takimet periodike të Grupit Rajonal të Punës për Mjedisin. KBR-ja së bashku me Kryetarin bashkërendon dhe e mbështet këtë proces duke u siguruar se Kryetari (potencialisht i shoqëruar nga një tjetër përfaqësues i Forumit) ftohet në takimet e GRP-së Mje. dhe në agjendën e takimit caktohet një interval kohor për prezantimin e përfundimeve dhe propozimeve të Forumit. Forumi i OJQ-ve ftohet gjithashtu të japë inputet për procesin vjetor të raportimit për zbatimin e AGJBP-së si dhe të kontribuojë në ciklin e monitorimit të Deklaratës së Sofjes.

Në këtë mënyrë, dialogu i përhershëm i bashkërenduar nga KBR-ja, bashkëpunimi më i fortë mes OJQ-ve dhe autoriteteve të Ballkanit Perëndimor, dhe gjithashtu bashkëpunimi mes OJQ-ve rajonale dhe atyre europiane sjell një shumëllojshmëri përfitimesh dhe mundëson ngritjen e kapaciteteve shtesë të sektorit jo-qeveritar në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Forumi i OJQ-ve luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe shpërndarjen e informacionit për objektivat e Agjendës të Gjelbër, statusin dhe progresin e përpjekjeve për mbrojtjen e mjedisit tek të gjithë qytetarët e Ballkanit Perëndimor.

PJESËMARRJA NË QEVERISJEN VENDORE

Qeveritë Vendore (QV-të) luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në zbatimin e Deklaratës së Sofjes dhe kontribuojnë në përmbushjen e angazhimeve të Udhëheqësve të Ballkanit Perëndimor të dakordësuara gjatë Samitin e Sofjes për Procesin e Berlinit. QV-të kontribuojnë dhe mund të përshpejtojnë zhvillimin e gjelbër dhe transformimin e dëshiruar të rajonit nëpërmjet planifikimit të hapësirës, veprimeve lokale për klimën, menaxhimin të energjisë së sektorit publik, sistemeve inteligjente të energjisë, lëvizshmërisë urbane, zhvillimit të nyjeve ndërmodale dhe infrastrukturës së transportit, zhvillimit të strategjive lokale për energjinë dhe klimën, zbatimin të zgjidhjeve të bazuara tek natyra përmes gjelbërimit të zonave urbane, integritit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në zhvillimin urban dhe planifikimin e tij, menaxhimin të mbetjeve, trajtimin të ujrave të zeza, si dhe përmes shumë masave të tjera. Nga ana tjetër, përvoja e tyre në zbatimin e politikave me rëndësi në nivel ekonomish të Ballkanit Perëndimor dhe zbatimi i kërkesave ligjore mund të ofrojë mbështetje të mëtejshme në proceset e politikë-bërjes duke dhënë reagime unikale në qasjen poshtë-lart. Të kuptuarit e nevojave dhe shqetësimeve të autoriteteve lokale dhe angazhimi më i gjerë i komuniteteve lokale në një proces vendim-marrjeje më gjithëpërfshirës me autoritetet e Ballkanit Perëndimor do të përshpejtonte tërë procesin dhe do të ndihmonte në përcaktimin e objektivave më realistë po aq sa dhe ambiciozë në nivel ekonomish të Ballkanit Perëndimor dhe në përgjithësi. Për këtë arsye, një element jetik për lehtësimin e zbatimit të Deklaratës së Sofjes është bashkëpunimi mes QV-ve në rajon dhe ofrimi i reagimeve të bashkërenduara vertikalisht për të lehtësuar procesin e politikë-bërjes.

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka rreth 520 bashki me një potencial të jashtëzakonshëm për të nxitur zhvillimin e gjelbër dhe për të mbështetur rritjen e ndërgjegjësimit mes qytetarëve të Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, bashkive shpesh u mungojnë përvoja dhe njohuritë, mundësitë e financimeve dhe hasin shumë sfida të tjera gjatë punës së tyre të përditshme, që lidhen por nuk kufizohen me zbatimin e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe zgjidhjen e ndryshimeve klimatike. Bashkitë janë gjithashtu përgjegjëse

për një nga çështjet më të ngutshme mjedisore siç është menaxhimi i mbetjeve dhe trajtimi i ujrave të ndotura. Duke patur këtë parasysh, KBR-ja synon të ndërtojë kuadrin e bashkëpunimit për bashkitë, që do të mundësonte shkëmbimin e njohurive, rritjen e ndërgjegjësimit, dhe do të lehtësonte veprimtaritë financuese dhe përsëritëse shembujt e praktikave më të mira në ndihmë të objektivave të AGJBP-së në rajon. Iniciativa do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me partnerët më në zë si NALAS, unionet e bashkive e shumë të tjera.

Iniciativa do të bazohet në cikle vjetore bashkëpunimi dhe procese shkëmbimi njohurish të cilat do të kulminojnë në formën e Ditëve të Agjendës të Gjelbër për qeverisjet vendore. Eventet e Ditëve të Agjendës të Gjelbër (DAGJ) do të organizohen në formën e një konference vjetore e cila preferohet të mbahet para takimeve periodike vjetore ministrore sipas kuadrit të GRP Mje. Këto evente do të shërbejnë për prezantimin e projekteve të zbatuara me sukses e që lidhen me Agjendës e Gjelbër, arritjet që kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit, në zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve të Ballkanit Perëndimor. DPGJ-ja do të shërbejë gjithashtu si një platformë për shkëmbimin e njohurive, bashkëpunimin dhe punën në rrjet mes përfaqësuesve të QV-ve. Për të rritur shtrirjen e platformës dhe për të frymëzuar përsëritjen e historive të suksesit, një nga rezultatet e DAGJ-së do të jetë një bulletin në format të printuar apo elektronik që do t'u dërgohet të gjitha bashkive në rajonin e Ballkanit Perëndimor. DAGJ-ja do të parashikojë segmentin e çmimeve Kampion i Agjendës së Gjelbër (për t'u përdorur për gjelbërimin e mëtejshëm të qytetit/qytezës apo për veprimtari dhe fushata promovuese) me qëllim motivimin e mëtejshëm të përfaqësuesve nga bashki të ndryshme që të prezantojnë arritjet e tyre dhe t'i ndihmojnë të tjerët përmes shkëmbimit të njohurive të tyre. Bashkitë e suksesshme që arrijnë dhe dokumentojnë progres më të madh në zbatimin e Programit të Gjelbër do të ftohen në takimin e GRP-së Mje. për të prezantuar projektin për të cilin

kanë marrë dhe çmimin. I tërë procesi do të mbështetet nga KBR-ja në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e rëndësishëm. Kjo iniciativë do të përpiqet gjithashtu të forcojë bashkëpunimin me iniciativat ekzistuese të BE-se e të tjera si ato, si për shembull: Marrëveshja e Kryebashkiakëve²³, Iniciativa Europiane e Javës së Lëvizshmërisë²⁴, Aleanca Urbane,²⁵ Kryeqyteti i Gjelbër European²⁶, dhe të tjera të ngjashme me këto.

PLATFORMA E BASHKËRENDIMIT TË DONATORËVE DHE FINANÇIMI I AGJBP-SË

Për të mirëorganizuar mbështetjen dhe për të siguruar se burimet e pakta përdoren në mënyrën më efikase të mundshme, KBR-ja do të organizojë takime të bashkërendimit të donatorëve për Agjendës e Gjelbër të Ballkanit Perëndimor. Këto takime do të organizohen si evente periodike vjetore për të identifikuar nevojat dhe përparësitë për rajonin në fjalë si dhe për të shqyrtuar mundësitë për ndërhyrje konkrete dhe për të ofruar mbështetje kur ka. Takimet e përvitshme do të inkurajonin bashkërendimin e donatorëve, do të mundësonin shkëmbimin e pikëpamjeve mes donatorëve në lidhje me gjendjen aktuale të zbatimit të Deklaratës së Sofjes dhe do të lehtësonin diskutimin për çështje të ndryshme dhe strategjinë për hapat e mëtejshme. Kjo platformë do të forconte gjithashtu lidhjet mes donatorëve dhe autoriteteve të Ballkanit Perëndimor dhe do të maksimizonte impaktin që do të kishin në zhvillim programet e mbështetura nga donatorët përmes përafrimit të tyre më të mirë me programet e ekonomive të Ballkanit Perëndimor. Këto takime do t'u mundësonin gjithashtu pjesëmarrësve të prezantonin programet e tyre, të qartësonin nevojat për investim dhe të promovonin projekt-idetë e reja për mbështetje nga donatorët.

Në takime do të diskutohen kapacitetet përthithëse të autoriteteve në ekonomitë e Ballkanit Perëndimor dhe do të shqyrtohen mundësitë për t'i nxitur ato përmes ngritjes

²³ <https://www.covenantofmayors.eu/>

²⁴ <https://mobilityweek.eu/home/>

²⁵ <https://www.iucn.org/regions/europe/our-work/nature-based-solutions/iucn-urban-alliance>

²⁶ <https://ec.europa.eu/environment/europeangreencapital/winning-cities/>

së kapaciteteve dhe bashkërendimit ndërkufitar. Gjithashtu këto takime do të shërbejnë si platformë për të diskutuar përmirësimin e efektshmërisë dhe efikasitetit të mbështetjes së dhënë përmes bashkëpunimit rajonal dhe për të identifikuar mundësitë e përsëritjes së iniciativave të zbatuara në mënyrë të suksesshme në mbarë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Takimet për bashkërendimin e donatorëve do të ofrojnë një kuadër diskutimi për financimin e gjelbër dhe të qëndrueshëm ndërsa u duhet dhënë përparësi projekteve me ndikimin më të madh pozitiv në klimë dhe mjedis. KBR-ja do të sigurohet për pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga komuniteti i donatorëve në takimet periodike të GRP Mje. si organi kryesor për bashkërendimin e zbatimit të Deklaratës së Sofjes.

Instrumentet e jashtme nën Kuadrin tjetër Shumëvjeçar Financiar të BE-së (2021-2027), IAPZHR-ja me 11 masat e veta dhe Instrumenti i Asistencës së Para-Aderimit (IPA) III do të jenë instrumentet financuese për të nisur veprimet dhe tranzicionin e gjelbër në shkallë të gjerë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Ato mund të përdoren për sektorin e bujqësisë dhe prodhimit ushqimor, si dhe për efikasitetin energjetic, energjitë e renovueshme dhe iniciativat drejt një ekonomie të qëndrueshme, efikente me burimet dhe me nivele të ulta karboni. Megjithatë, për sa kohë kjo nuk do të mjaftonte, do të ishin me mjaft rëndësi fondet shtesë nga ekonomitë e Ballkanit Perëndimor, mbështetja nga VE BE, mobilizimi i investimeve private si dhe financimi i konsiderueshëm nga institucionet ndërkombëtare financiare (INF-të). Tranzicioni i gjelbër që parashikohet në rajonin e Ballkanit Perëndimor do të kërkojë grumbullimin e instrumenteve ekzistuese por edhe zhvillimin e instrumenteve novatorë të asistencës financiare, siç janë bondet e gjelbra. Përdorimi i burimeve ekzistuese të mbështetjes financiare do të ketë një pasojë galvanizuese për vetë burimet e ekonomive të Ballkanit Perëndimor ashtu edhe për investitorët privatë e të tjerë. Në të ardhmen duhet maksimizuar potenciali i Kuadrit të Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP) me dy mekanizmat e vet të kombinuar, Fondin e Gjëbërimit për Zhvillim (FGJZH) dhe Programin Rajonal për Efikasitetin Energjetic, të cilat tashmë mbështesin shumë veprimtari që lidhen me AGJBP-në në rajon.

PJESËMARRJA E KOMUNITETIT TË BIZNESIT, RINISË DHE GRUPEVE VULNERABËL, PËRFSHIRË KOMUNITETIN ROM

Komuniteti i biznesit i Ballkanit Perëndimor mund të jetë faktor shtesë për lehtësimin dhe përshpejtimin e zbatimit të angazhimeve të Deklaratës së Sofjes. Pjesëmarrja potenciale e komunitetit të biznesit është diskutuar me aktorë të ndryshëm gjatë fazave fillestare të zbatimit të Deklaratës së Sofjes. Mendimi i përbashkët është se ekziston nevoja për të informuar, mbështetur dhe motivuar më mirë komunitetin e biznesit dhe për ta bërë atë pjesë integrale të procesit të zbatimit përmes një bashkërendimi më të mirë të punëve. Nga ana tjetër, i tërë komuniteti i biznesit të Ballkanit Perëndimor do të ndikohet nga transformimi i parashikuar gjithëpërfshirës ekologjik sipas AGJE-së dhe instrumenteve të planifikuara në mbështetje të dekarbonizimit përtej kufijve të BE-së. Për këtë arsye, proceset dhe transformimi i pritshëm i sektorit të industrisë do të kërkojë një modernizim dhe transformim të shpejtë, duke ndjekur hapin e përcaktuar nga angazhimet e Agjendës së Gjelbër, përndryshe, transformimi i pritshëm ekologjik me objektivat e tij do të kërcënojë deri diku ata të cilët vonojnë të përqafojnë paradigmen e re, duke rrezikuar kështu të humbasin pjesën që zënë në treg, fuqinë dhe të ardhurat.

Komuniteti i biznesit në Ballkanin Perëndimor inkurajohet të krijojë kuadrin e duhur për të optimizuar praktikën e tyre, për të zgjedhur financimin e përshtatshëm, për të miratuar parimet e ekonomisë qarkulluese, për t'i dhënë përparësi reduktimit dhe ripërdorimit të materialeve, për të prodhuar produkte të qëndrueshme dhe të riciklueshme, për të reduktuar paketimin dhe për të rritur përdorimin e materialeve të ripërdorur apo të ricikluar për paketim. Përmes këtij modeli të ri të biznesit, konsumatorët në Ballkanin Perëndimor do të fuqizohen të bëjnë zgjedhje të informuara, ndërsa praktikatat e reja për prodhuesit dhe produktet do të gjenerojnë ndryshime pozitive në sjelljen konsumatore. Komuniteti i biznesit në Ballkanin Perëndimor inkurajohet të shqyrtojë një model të ri biznesi që përfshin sipërmarrjen e gjelbër, investimet e qëndrueshme, dizajnon qarkulluese, dhe angazhime sipas

Paktit European te Klimës (PEK) ndërsa përqafojnë politika të qëndrueshme produktesh, përgjegjësi të zgjeruar prodhuesish dhe parandalimin e produkteve të dëmshme për mjedisin nga tregtimi në tregun e Ballkanit Perëndimor. Në të njëjtën kohë, sipërmarrjet e menaxhimit të mbetjeve, veçanërisht ato të cilat angazhojnë grupet vulnerabel, si komunitetin rom, duhen mbështetur për t'u rritur dhe zhvilluar, dhe për të përvetësuar modele novatore biznesi. Në fazat e para të zbatimit, duhet t'i kushtohet vëmendje në veçanti sektorëve me intensitet burimesh si ndërtimi, tekstilet, plastika dhe elektronika. Në procesin e mbështetjes së transformimit të sektorit të biznesit në Ballkanin Perëndimor, Forumi i Dhomave Të Investimit të Ballkanit Perëndimor (FDHI) do të luajë një rol kyç më KBR-në për të siguruar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të komunitetit të biznesit si pjesë e procesit gjithëpërfshirës të qeverisjes.

Një tjetër aktor domethënës në zbatimin e AGJBP-aë është rinia, një agjent i rëndësishëm ndryshimi. Rinia është ajo që do të ndikohet më tepër nga veprimet e sotshme, veçanërisht në lidhje me urgjencën klimatike, krizën në natyrë, menaxhimin e mbetjeve e kështu me radhë. Për këtë arsye, brezi i ri ka interesa, të drejta por dhe detyrime për të marrë pjesë në proces duke sjellë ide novatore, mendimin kritik, dhe qasjen moderne për përshpejtimin e zbatimit të AGJBP-së. Në këtë kuptim, Zyra e Bashkëpunimit Rajonal të Rinisë (ZBRR) dhe Laboratori Rinor i KBR-së do të jenë partnerë kryesorë për bashkëpunim në këtë fushë, ndërsa KBR-ja do t'u ofrojë përfaqësuesve rinorë një mundësi për të prezantuar shqetësimet, pikëpamjet dhe propozimet e tyre për përmirësim, duke siguruar në këtë mënyrë vazhdimësinë e pjesëmarrjes së tyre të përkushtuar në drejtimin e zbatimit të Deklaratës së Sofjes.

Ekonomia qarkulluese dhe sipërmarrja e gjelbër përbëjnë një potencial të pashfrytëzuar për fuqizimin e grave, veçanërisht në kontekstin e pandemisë COVID-19 që i ka ndikuar rëndë. Sipërmarrjet sociale dhe mjedisore, që vendosin në fokus të rimëkëmbjes së gjelbër barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, janë një element themelor që çon në

zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërive të Ballkanit Perëndimor. Një ekonomi e gjelbër gjithëpërfshirëse vendos në qendër qëndrueshmërinë sociale dhe mjedisore që mund të fuqizojë gratë dhe vajzat si sipërmarrëse dhe prodhuese. Për këtë arsye, mikro-bizneset dhe sipërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMV-të) të drejtuara nga gratë duhet të jenë në ballë të procesit të rimëkëmbjes ekonomike, me në qendër tranzicionin e gjelbër dhe të drejtë.

Së fundi, dhe më e rëndësishmja, edhe pse komuniteti rom përfaqëson një potencial të madh për ekonominë në Ballkanin Perëndimor, aftësia e tyre për të kontribuar aktivisht po shkon dëm për shkak të marginalizimit. Rreth 61% forcës së punës së komunitetit rom në rajon është e angazhuar në sektorin informal, kryesisht duke qenë pjesë e padukshme, edhe pse mjaft e rëndësishme e sistemit të menaxhimit të mbetjeve. Transformimi i këtij angazhimi në punën e gjelbër novatore të deklaruar do të mund të kontribuonte shumë në përmbushjen e objektivave të AGJBP-së, por edhe të objektivave të Deklaratës të Poznanit. Integrimi i Romëve i KBR-së mund të shërbejë si një partner për të siguruar përfshirjen e komunitetit rom në zbatimin e Deklaratës së Sofjes.

SISTEMI I MONITORIMIT

Monitorimi i vazhdueshëm i parametrave kryesorë të Deklaratës së Sofjes është një nga parakushtet kryesore për të garantuar zbatimin e qetë të saj. Monitorimi do të kryhet në cikle periodike bazuar në indikatorët e paracaktuar (të dhënë më poshtë) përmes të cilëve do të jetë e mundur të gjurmohet ecuria e zbatimit, niveli i arritjeve apo të identifikohen periudhat e stanjacionit dhe vonesat. Në këtë mënyrë, këto indikatorë do të ndihmojnë në identifikimin dhe analizimin e arsyeve në rast se procesi i zbatimit ngadalësohet apo qëndron në vend. Sistemi i monitorimit do të mundësojë gjithashtu

hartimin e veprimeve korigjuese për të kapërcyer problemet dhe garantimin e vazhdimësisë së veprimtarive pa ndërprerje.

Indikatorët sasiorë dhe cilësorë, që përbëjnë dhe sistemin monitorues, përcaktohen bazuar në rëndësinë që marrin për zbatimin e Deklaratës së Sofjes si dhe në disponueshmërinë e të dhënave përmes cikleve periodike të monitorimit.

Për të dhënë një prezantim pamor për ecurinë e zbatimit të Deklaratës së Sofjes, KBR-ja do të zhvillojë Observatorin e AGJBP-së, një platformë në rrjet, mjaft e lehtë për t'u

përdorur me të gjithë indikatorët e grupuar sipas fushave të politikave, sipas ekonomive të Ballkanit Perëndimor apo rajonit si një i tërë, me afatet kohore, mjetet mbështetëse të web-it për parametra të ndryshëm, dhe me bazat e të dhënave për t'u plotësuar nëpërmjet cikleve vjetore të mbledhjes së të dhënave. Kjo platformë do të sigurojë që grupe të ndryshme përdoruesish, përfshirë këtu politikë-bërësit, studiuesit, organizatat rajonale, donatorët, qytetarët dhe shumë të tjerë, të kenë mundësi ta përdorin atë për të kuptuar dhe gjurmuar më mirë statusin e zbatimit.

INDIKATORËT

	Nr.	Indikator	Burimi i të dhënave
Veprimi klimatik	1.	Emetimet GS në total (ton CO ₂ eq)	Inventare të GS/Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit/Zyrat e Statistikave
	2.	Intensiteti i emetimeve të GS i gjenerimit të fuqisë (ton CO ₂ eq)	Raporte të KEn/Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit/Zyrat e Statistikave
	3.	Numri i politikave sektoriale që përfshijnë përshtatjen e ndryshimit klimatik	Progres Raporti i KE-së/Deklaratë për Politikën e BE-së për Zgjerimin
	4.	Niveli i financimit për klimën	Progres Raporti i KE-së/Deklaratë për Politikën e BE-së për Zgjerimin
Energjia	1.	Përqindja e zbatimit energji elektrike	Raporti i Zbatimit KEn
	2.	Përqindja e zbatimit energji e rinovueshme	Raporti i Zbatimit KEn
	3.	Përqindja e zbatimit gazit	Raporti i Zbatimit KEn
Transporti	1.	Direktiva/rregullore/standarde/specifikime të transpozuar të rëndësishme	Raport Progresi i planit të veprimit të TKT-së/raporte të Komitetit Teknik
	2.	Strategjitë e Ballkanit Perëndimor të përditësuara më elemente të qëndrueshëm dhe inteligjentë	Raporte të ecurisë së Lëvizshmërisë Inteligjente dhe të Qëndrueshme/takime të grupit ad hoc
	3.	Infrastruktura e zhvilluar sipas TEN-T (lidhur me elementet e gjelbër)	Planet Vjetore TEN-T

	Nr.	Indikator	Burimi i të dhënave
Economia Qarkulluese	1.	Konsumi material i brendshëm për frymë	http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=t2020_rl110&lang=en Zyrat e Statistikave
	2.	Konsumi material i brendshëm	http://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=t2020_rl110&lang=en Zyrat e Statistikave
	3.	Produktiviteti i burimeve	https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/env_ac_rp/default/table?lang=en Zyrat e Statistikave
	4.	Gjenerimi i mbetjeve - Total	https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/env_wasgen/default/table?lang=en Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit
Eliminimi i Ndotes	1.	Përqëndrimet ambientale vjetore të PMs, SO ₂ dhe NO _x	Raportet vjetore të cilësisë së ajrit për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit
	2.	Emetimet vjetore të PMtotal, PM ₁₀ , SO ₂ dhe NO _x nga impiantet e mëdha të djegies	Raporte vjetore të zbatimit të Ken Energy Community Homepage. (energy-community.org) Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit Konventa LRTAP Tabelat NFR
	3.	Emetimet vjetore të NH ₃ dhe NMVOC	Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit Konventa LRTAP dhe tabelat NFR
	4.	Popullësia me lidhje në sistemin e furnizimit me ujë (%) dhe Popullësia me lidhje në sistemin e trajtimit të ujrave të ndotura (%)	Zyrat e Statistikave të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, Eurostat
	5.	Klasifikimi i tokës artificiale për frymë sipas tipit	Zyrat e Statistikave të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, Eurostat/Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit (Klasifikimi i Tokës sipas sistemit Corine)
	6.	Nitrati në ujrata nëntokësore	Zyrat e Statistikave të ekonomive të Ballkanit Perëndimor, Eurostat/Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit
Bujqësia e qëndrueshme	1.	Përqindja e hapësirës nënshtruar bujqësisë organike në totalin e hapësirës së përdorur për bujqësi	Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit Gjendja State of the Environment Reports
	2.	Përqindja e tokës nën menaxhimin që kërkon reduktimin në inpute kimike	
	3.	Mesatarja e përmbajtjes së karbonit organik në tokën bujqësore	Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit Raporte të Gjendjes së Mjedisit
	4.	Prodhimi i energjisë së rinovueshme nga bujqësia	
	5.	Emetimet GS nga bujqësia (ton CO ₂ eq)	Agjencitë e Mbrojtjes së Mjedisit Raporte të Gjendjes së Mjedisit
	6.	Numri i fermave dhe sipërmarrjeve të përpunimit të ushqimeve që marrin mbështetje (IAPZHR) për të harmonizuar me standardet e higjenes dhe mirëqenies shtazore	

	Nr.	Indikator	Burimi i të dhënave
Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit	1.	Zona të përcaktuara si të mbrojtura dhe të konservuara detare dhe tokësore përshirë MTEK	UNEP-WCMC Baza e të Dhënave Botërore për Zonat e Mbrojtura (BBZM) https://www.protectedplanet.net/en/thematic-areas/wdpa?tab=WDPA Baza e Të Dhënave Botërore për Masa të Tjera Efikase të Konservimit bazuar tek zonat (BBMTEK) https://www.protectedplanet.net/en/thematic-areas/oecms?tab=OECMs
	2.	Zonat dhe rrjetet ekologjike mbarë ekonomike Potential Natura 2000	Baza europiane e të dhënave Natura 2000, të dhëna për rrjetet ekologjike https://www.eea.europa.eu/data-and-maps/data/natura-2000-eunis-database
	3.	Indeksi i Mbrojtjes së Specieve	Lista e kuqe rajonale dhe e ekonomive të Ballkanit Perëndimor https://www.iucnredlist.org/
	4.	Efektiviteti i menaxhimit të zonave të mbrojtura	
	5.	Programet e rimëkëmbjes së specieve	Planet e veprimeve rajonale dhe mbarë-ekonomike për specie
	6.	Hapësira e piezazheve të restauruara pyjore	Barometri i Sfidës së Bonit https://infoflr.org/bonn-challenge-barometer
	7.	Fenologjia e specieve të përgjedhura të bimëve dhe kafshëve	Pokazatelji i izvori verifikacije koji će biti dogovoreni na temelju regionalnog strateškog plana za biodiverzitet.
	8.	Strategjia e Biodiversitetit dhe Planet e Veprimit për ekonomitë e Ballkanit Perëndimor (SBPV)	Indikatorët dhe burimet e verifikimit për t'u dakordësuar bazuar në planin strategjik rajonal për biodiversitetin https://www.cbd.int/conferences/post2020

RAPORTIMI

Në bashkëpunim të ngushtë me organizatat rajonale dhe me Komisionin Europian, KBR-ja do të krijojë një mekanizëm raportues që përbëhet nga i) një raport vjetor përshkruar dhe ii) një përmbledhje vjetore e indikatorëve.

Raporti përshkruar do të zhvillohet bashkarisht me të gjithë partnerët përgjegjës për fushat e politikave dhe aktorët tjerë të përfshirë në procesin e zbatimit të Deklaratës së Sofjes. Për këtë arsye, pjesa përshkruese do të ketë një përmbledhje të ecurisë në të shtatë elementët përbërës të Deklaratës së Sofjes dhe do të plotësohet me më shumë se shtatë kapituj: këndvështrimi i OJQ-ve; pikëpamja e Qeverisjes Vendore; pikëpamja e Donatorëve; pikëpamja e komunitetit të biznesit, apeli i Rinisë. Raporti duhet të jetë i shkurtër e me përmbajtje për të dhënë një përmbledhje të përpiktë të veprimtarive të kryera dhe rezultateve të arritura kundrejt objektivave të synuara.

Përmbledhje e indikatorëve do të përgatitet bashkarisht nga KBR-ja dhe organizatat rajonale partnere mbi parametrat kyçe përmes të cilave gjurmohet dhe progresi. Kjo pjesë do të jetë në formën e një prezantimi pamor të statusit të zbatimit shoqëruar me një shpjegim përshkruar të parametrave kyçe ku jepet një përpunim i një statusi të caktuar, veçanërisht në rastin e rënies së ecurisë apo vonesave të evidentuara në përmbushjen e objektivave me propozimet përkatëse për masa korrigjuese.

Këto elementë do të përbëjnë Raportin e Agjendës të Gjelbër për Zbatimin (RAGJZ) që do të hartohet nga KBR-ja para se të mbahen takimet periodike ministrore të GRP Mje. (zakonisht në tremujorin e fundit të çdo viti) dhe që do t'u paraqitet Ministrave për miratim. Bazuar në këtë raport vjetor, Ministrat e GRP Mje. bashkë me Ministrat nga të tjera Ministri të linjës do të miratojnë Deklaratën e Përbashkët përmes së cilës ofrohen udhëzime të mëtejshme dhe, nëse nevojiten, kërkesa për masa korrigjuese apo përpjekje të përforcuara zbatimi për vitin e ardhshëm. Së bashku me KE-në dhe partnerë të tjerë, KBR-ja do të jetë përgjegjëse për integrimin e elementeve të Deklaratës së Përbashkët në programin e punës për vitin e ardhshëm dhe për garantimin e zbatimit të tij.

KOMUNIKIMI, RITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE PJESËMARRJA E QYTETARËVE

Një komponent i rëndësishëm i procesit të zbatimit të Deklaratës së Sofjes do të jetë përfshirja e qytetarëve të Ballkanit Perëndimor dhe informimi i tyre për objektivat, nevojat dhe veprimtaritë që po ndërmarrin autoritetet e tyre për të garantuar transformimin rrënjësor ekologjik sipas Agjendës të Gjelbër. Përditësimi i qytetarëve në lidhje me progresin e arritur dhe komunikimi i duhur i objektivave të AGJBP-së duhet t'i motivojë ata më tej për t'u angazhuar personalisht dhe për të kontribuar në kauzë duke ndryshuar sjelljen tyre në përputhje me qëllimet e përbashkëta të mbrojtjes së mjedisit dhe të reaguari nga ndryshimeve klimatike. Roli i qytetarëve nuk duhet të shpërfilllet për sa i përket reduktimit të emetimeve përmes burimeve alternative të energjisë, izolimit të shtëpive, menaxhimit të energjisë dhe efikasitetit të përmirësuar, zgjidhjeve alternative dhe kolektive të transportit, pakësimit të gjenerimit të mbetjeve, diferencimit dhe riciklimit të mbetjeve, ndyshit të modeleve të konsumit dhe në përgjithësi ky rol ka një ndikim të konsiderueshëm në reduktimin e gjurmës mjedisore në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Për këtë arsye, gjatë këtij dhjetëvjeçari, i është dhënë vëmendje e caktuar komunikimit të duhur të objektivave të Deklaratës së Sofjes, statusit të zbatimit të saj si dhe përfitimeve që do t'u sjellë ajo të gjithë qytetarëve të Ballkanit Perëndimor. Së bashku me të gjithë partnerët e përfshirë në zbatim, KBR-ja do të organizojë fushata të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit për të informuar qytetarët e Ballkanit Perëndimor dhe për t'i ftuar ata të veprojnë, duke përfshirë këtu dhe parashikimin e disa mekanizmave specifikë të informimit për të shkuar pranë atyre komuniteteve ku zor se shkohet, si komuniteti rom dhe grupet vulnerabël. Mes instrumenteve të tjerë, website-i i KBR-së, bashkë me Observatorin e AGJBP-së do të jenë burime të rëndësishme informacioni për zbatimin e AGJBP-së. Do të publikohen materiale të ndryshme, broshura dhe fletëpalosje në gjuhët vendase për t'iu shpërndarë publikut të gjerë. Të gjithë partnerët do të ftohen të hartojnë dhe zbatojnë fushata ndërgjegjësimi dhe të raportojnë në ciklet vjetore të raportimit përmes një procesi gjithëpërfshirës qeverisjeje. Qeverisjet Vendore do

të luajnë një rol të veçantë në këto veprimtari përmes pjesëmarrjes në iniciativa të ndryshme si Iniciativa e Rajoneve të Ajrit të Pastër, duke organizuar ditët pa makina sipas Javës Europiane të Lëvizshmërisë, duke prezantuar zona këmbësorësh dhe ciklistësh, duke promovuar arritjet në menaxhimin e energjisë, duke luajtur një rol të përveçëm në rinovimin e ndërtesave publike, dhe në iniciativa të ngjashme me këto. Roli i QV-ve do të promovohet dhe forcohet nëpërmjet iniciativës së Ditëve të Agjendës të Gjelbër.

Për të siguruar promovimin dhe ndërgjegjësimin e vazhdueshëm publik, si dhe qasjen e përqëndruar rajonale, dita e miratimit të Deklaratës së Sofjes (10 nëntori) do të shpallet

Përvjetori i Agjendës të Gjelbër për Ballkanin Perëndimor dhe si pjesë e platformave të ngritura mbi të gjitha organizatat rajonale, OJQ-të, qeveritë lokale, komuniteti i biznesit dhe i rinisë do të ftohen të kremtojnë këtë datë duke ndërmarrë masat e duhura apo duke organizuar veprimtari promovuese.

Për të plotësuar të gjitha këto përpjekje, KBR-ja do të përpiqet gjithashtu të zhvillojë dhe forcojë rrjetin e ambasadorëve të Paktit European të Klimës në Ballkanin Perëndimor për të motivuar organizata të ndryshme që të marrin angazhime për klimën sipas kësaj iniciative.

SHKURTIME

AEM	Agjencia Europiane e Mjedisit
AGJBP	Agjenda e i Gjellbër për Ballkanin Perëndimor
AGJE	Agjenda e i Gjellbër Europiane
BE	Bashkimi Europian
BP	Ballkani Perëndimor
CoP	Conference of the Parties
DEI	Direktivës së Emetimeve Industriale
Direktiva AKE	Direktiva e Angazhimeve Kombëtare për Reduktimin e Emetimeve
DP FNZ	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit
DP	Drejtoria e Përgjithshme
DPGJ	Ditët e Agjendës të Gjellbër
EJL	Europa Jug-Lindore
EQ	Ekonomi Qarkulluese
FDHI	Forumi i Dhomës së Investimeve
FGJZH	Fondin e Gjëbërimit për Zhvillim
GPKRE	Grupi i Punës Këshillimor dhe Rajonal i Ekspertëve
GPP ZHRR	Grupi i Përhershëm i Punës për Zhvillimin Rural Rajonal
GRP Mje.	Grupi Rajonal i Punës për Mjedisin
GS	Gazet Serrë
IAP	Instrumentit për Asistencës Para-aderimit
IAPZHR	Instrumentit për Asistencës Para-aderimit për Zhvillimin Rural
INF-të	Institucionet Ndërkombëtare Financiare
IvHE	Impiante të Vogla Hidro-Energjitike
KB	Kombet e Bashkuara
KBR	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
KDB	Konventa për Diversitetin Biologjik

KE	Komisioni Europian
KIBP	Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor
KiD	Komiteti i Dekarbonizimit
KKKBNK	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
KPK	Kontributi i Përcaktuar Ndërkombëtarisht
LEADER	Liaison Entre Actions de Développement de L'économie Rurale (Lidhjet mes veprimeve për zhvillimin e ekonomisë rurale)
MPKK	Mekanizmi i Përshtatjes së Kufirit të Karbonit
NNARRGJ	Ndotjen Ndërkufitare të Ajrit me Rreze të Gjatë
NPR	Nomenklatura për Raportimin
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
OZHQ	Objektiv i Zhvillimit të Qëndrueshëm
PEK	Pakti Europian i Klimës
PKEK	Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën
PKP	Plani Kombëtar i Përshtatjes
PKRE	Plane Kombëtare për Reduktimin e Emetimeve
PMB	Produkte për Mbrojtjen e Bimës
PNNK	Panelit Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike
PNSHBE	Platforma Shkencore-politike Ndërqeveritare për Shërbimet e Biodiversitetit dhe Ekosistemit
POPJM	Përbërësit Organikë të Paqëndrueshëm Jo-Metan
PPB	Politika e Përbashkët Bujqësore
PPMA	Programi i Partneritetit Mjedisor për Aderimin
PPP	Përmirësimi i Peizazhit Pyjor
PREE	Programi Rajonal i Efiçencës Energjitike
PV	Plani i Veprimit
PVEQ	Programi i Veprimit për Eliminimin e Qymyrit
QPK	Qendra të Përbashkëta Kërkimore

QV	Qeverisja Vendore
RPGJZ	Raporti i Agjendës të Gjelbër për Zbatimin
Rregullore PTNPTP	Rregullore për përfshirjes së emetimeve të gazeve serrë dhe eliminimit nga Përdorimi i Tokës, Ndryshimeve të Përdorimit të Tokës dhe Pylltaria
RREIVM	Rrjetit European i Informacionit dhe Vëzhgimit Mjedisor
RRKZHRR	Rrjeti Kombëtar i Zhvillimit Rural
RVAKK	Regjistrimi, Vlerësimi, Autorizimi dhe Kufizimi i Kimikateve
SIBE	Sistemi Informativ i Biodiversitetit për Europën
SKEn	Sekretariati i Komunitetit të Energjitikës
SNNJB	Sistemi i Novacionit dhe Njohurive Bujqësore
SPKT	Sekretariati i Përhershëm i Komunitetit të Transportit

SRP	Strategjia Rajonale e Përshtatjes
STE	Sistemi i Tregëtimit të Emetimeve
SVM-të	Sipërmarrje të Vogla dhe të Mesme
SZHKU	Strategjia e Zhvillimit të Karbonit të Ulët
TFBD	Task Forca e Biodiversitetit
TKT	Traktati i Komunitetit të Transportit
TMD-të	Teknikat më të Mira në Dispozicion
TPR	Tregu i Përbashkët Rajonal
UNRN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
VA	Vend Anëtar
ZBRR	Zyra e Bashkëpunimit Rajonal për Rininë

